BORDO
N. 64 NËNTOR 2023
VITI VIII I BOTIMIT
ÇMIMI 500 LEKË

BORDO

NËNTOR 2023

ART
GAZMEND LEKA

FASHION ICON
ERANDA LIBOHOVA

PERSONAZHE
ABDO FEGHALI
EVI REÇI
ARGJEND LLOGA
SONILA ÇAUSHI
SKERDI FARIA
MIRA POGAÇI

ENDI *Dennori* ON TOP

ART GATIM DHE SHIJE
NGA
GËZIM MUSLIAKA



FOTOGRAFIA: JUXHIN KURTI
MUAH: SALLON FRIDA, XHOI & XHEI
VENDNDODHJA: PALLATI I BRIGADAVE





ENDI Demneri On Top

E rritur në një familje të madhe, herë duke provuar fustanet e bukur, e herë duke u grimuar apo rregulluar flokët, për Endin ka qenë krejt normale që një ditë të gjendej në një pasarelë mode. Nga vajza e kopertinave të revistave dhe fotosesioneve, fytyra e saj u shfaq si imazh i markës prestigjioze "Dolce & Gabbana", ndërsa së fundmi gjithë puna e saj është finalizuar si "Miss Universe Albania". Tani më të bukurën e Shqipërisë e pret një tjetër sfidë në skenën e "Miss Universe", ku pritet të udhëtojë për pak ditë. Ky është momenti i Endit, koha që ajo të shkëlqejë si një yll në universin e më të bukurave të globit, një rrugëtim emocionues që ajo mezi pret ta përjetojë.

Endi, kanë mbetur dhe pak ditë për të udhëtuar drejt "Miss Universe", si ndiheni?

E emocionuar pafund! Do të përpiqem ta përfaqësoj në mënyrë sa më dinjitoze Shqipërinë tonë. Është kënaqësi dhe përgjegjësi e madhe njëkohësisht.

Besoj se e keni vendosur si do të prezantoheni, a mund të zbuloni disa detaje për "Bordo"?

Është një ekip i tërë që punon prej muajsh, për paraqitjen e Shqipërisë në "Miss Universe". Do të më 'mbysnin' po të nxirrja qoftë edhe detajin më të vogël. Çdo gjë do të jetë surprizë.

Si ka ndryshuar jeta e Endit nga momenti që fituat kurorën?

Unë jam një vajzë që kam qenë përherë e angazhuar, jo vetëm me shkollën, por edhe me modelingun.

U shfaqët në kopertinën e revistës "Bazaar", si ishte kjo eksperiencë?

Një eksperiencë unike! Jam ndier vërtet e vlerësuar!

Prej kohësh identifikoheni me "Dolce & Gabbana", si ndiheni si përfaqësuese e kësaj marke?

Për mua është privilegj dhe krenari e madhe të jem pjesë e familjes Dolce & Gabbana. "Dolce & Gabbana" është një nga shtëpitë më prestigjioze të modës në botë dhe ka patur pjesë të saj, figurat më të rëndësishme të botës. Padyshim për mua është ëndërr e bërë realitet.

Cila është kauza që mbështet Endi, si Miss dhe si vajzë?

Kam folur shpesh për Endometriosis, një sëmundje që prek rreth 10 për qind të vajzave e grave dhe që po të trajtohet në kohë dhe siç duhet, padiskutim që rrit cilësinë e jetës. Si një vajzë që jam prekur nga kjo sëmundje, përpiqem të ndihmoj sa më shumë të mundem, duke ofruar ndihmën time për të gjitha ato vajza e gra që jetojnë çdo ditë me Endometriosis. Kjo është edhe kauza ime!

Kujt ja dedikoni gjithë sukseset, arritjet në jetën tuaj, si një modele e afirmuar dhe jo vetëm?

Familja ime është mbështetja ime! Çdo sukses ia dedikoj familjes sime të madhe!

Çfarë raporti ke me tezet, a mund të na japësh një përcaktim për secilën?

Tezet e mia janë thjesht të mrekullueshme! Frida, themeluese e "Frida, Xhoi & Xhei", është një artiste me A të madhe. E talentuar, e përkushtuar, e jashtëzakonshme! Ishte pikërisht "Frida, Xhoi & Xhei" që më bëri të shkel në një pasarelë për herë të parë dhe mbi të gjitha, është ky brand që më konfirmoi si fotomodele. Diana, administratore e një prej qendrave më të njohura të estetikës në Tiranë, është një dashuri e madhe për mua. Ne jemi thjesht, njësoj! Jam me fat që kam dy teze të mrekullueshme!

Pa kurorë, thjesht si vajzë, si do ta përcaktoje Endin?

E shpenguar, këmbëngulëse, pak kokëfortë, por përherë me këmbë në tokë.

Ku e sheh veten pas 10 vitesh?

Po punoj fort dhe po investohem shumë, që të realizoj çdo qëllim që i kam vënë vetes. Do t'ua them në një intervistë pas 10 vjetësh, nëse ia kam dalë mbanë.

Së fundmi ka debate rreth transgjinoreve në konkurset e bukurisë, ju çfarë mendoni?

Jeto dhe lër te tjerët të jetojnë! Respektoj zgjedhjet e çdokujt!

Cila është blerja më e kushtueshme që keni në gardërobën tuaj?

Nuk i shikoj gjërat nga çmimet të them të drejtën, mund të jetë një gjë që ka kushtuar shumë pak, por ka një vlerë të madhe në shpirtin tim.

Po parfumi i preferuar?

Parfumi mendoj është diçka shumë personale. E kam krijuar në një nga butikët më prestigjioze në Paris, ku bënë bashkë dhe zgjodhën të gjitha fragrancat e mia të preferuara! Pra është një miks parajse.

Motoja që ju udhëheq në jetë?

Dija është fuqi! Kjo është motoja ime. Sa më shumë të zgjerosh horizontin, aq më shumë do t'i bësh ballë situatave të caktuara në jetë. Besoj shumë në Zot dhe mendoj që çdo hap që ndërmarr, e kam të bekuar.

E emocionuar pafund! Do të përpiqem ta përfaqësoj në mënyrë sa më dinjitoze Shqipërinë tonë. Është kënaqësi dhe përgjegjësi e madhe njëkohësisht



Raiffeisen Bank
Make it happen

EksplorON
me Raiffeisen ON



Zbulo vende të reja me kredinë personale në Raiffeisen ON

- Apliko tërësisht online
- Zero komision administrimi

Shkarko tani

Available on the App Store

GET IT ON Google Play

LMN
LONDON MEN



Xhupi **ETRO** | Pantallonat **JACOB COHEN**
Fotografia: Ergys Zhabjaku | **Disajn:** Dea Ademi

ADRESA
Blv. Bajram Curri, nd. 118

069400 9629
London Men Tirana

LONDON MEN



NË KOPERTINË

ENDI DEMNERI
ON TOP

FASHION ICON
ERANDA LIBOHOVA

ART
GAZMEND LEKA

PERSONAZHE
ABDO FEGHALI
EVI REÇI
ARGJEND LLOGA
SKERDI FARIA
SONILA ÇAUSHI
MIRA POGAÇI

ART, GATIM DHE SHIJE NGA
GËZIM MUSLIAKA



bordo.al
BORDO
NËNTOR 2023

COVER STYLE

20. Bordo IN

24. Trend – Dantellë magjepsëse

26. Trend – Shkëlqyese

28. Trend –Dallgë thekësh

30. Trend – Zjarr & akull

32. Trend – Prekje livando

34. Aksesorë – Aromë portokalli


36. Aksesorë – Më zgjidh!

38. Beauty – Bon Ton

40. Beauty – Kthim te natyra

42. Beauty – Platinium

44. Beauty – Perëndim dielli



bordo.al







Gjikondi

BULEVARDI "ZOGU I PARE", PALLATI 103, TIRANE · TEL NO +355684027360

bordo.al
BORDO









PERSONAZHET E BORDO

22. Facts – Mario Buccellati

46. Teoxane, sjell në Shqipëri dr. Shady Ismail

46. Jack Daniel's, mbjell pemë molle në Kopshtin Zoologjik të Tiranës

50. Fashion Icon – Eranda Libohova

58. ART - Gazmend Leka sjell Abel

60. Intervistë Evi Reçi

62. ART – Arnilda Kyçyku

64. Me stilin e... Sonila Çaushit!

BORDO MEN

68. Gadget

69. Estetikë Men

70. Cover Men – Abdo Feghali

74. Argjend Lloga


76. Me stilin e doktor Skerdit

78. Trend - Vishu me stil 50+

79. Trend – Këpucë elegante

80. Men W – Joel Edgerton










pasqualebruni.com - Made in Italy
PASQUALEBRUNI
Gjikondi
Bulevardi "Zogu i Pare", Pallati 103,Tirane
Cel. +355 68 4027360

bordo.al
BORDO









STIL JETESE

95. Event – Red Bull Car Park Drift

96. Event – Në tapetin e kuq të "Në kuadër të dashurisë"

98. Horoskopi nëntor 2023

99. Bibliotekë – Librat e rinj





STIL JETESE

82. Travel – Edinburgh dhe Skocia nga Edlina Losha

84. Travel – Maligradi, të jetosh në ishull

86. Travel – Liqenet e Plitvicës

88. Interior – Dru & Metal

89. Interior – Ethet e arit

90. Chef Gëzim Musliaka - Marchesi Gourmet

92. Receta – 3 receta me mish për çdo shije







TAG HEUER

Driven by the sun.

Powered by its limitless energy.

BEYOND THE EDGE

TAG HEUER AQUARACER

Gjikondi

BULEVARDI "ZOGU I PARE", PALLATI 103, TIRANE

CEL +335 68 4027360

BORDO

Nën kujdesin e

ENADA AT'NIKOLLA

Drejtore

Ilda Lumani

Kryeredaktor

Olsi Kolami

Gazetarë

Nada Biraçi

Anita Aliaj

Marketing

Florida Gavoçi

Në këtë numër bashkëpunuan

Fadil Berisha

Eda Bano

Leo Arapaj

Design & Layout

Altin Aliaj

Revista BORDO

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara.
BORDO është markë e regjistruar.
Ndalohet me ligj çdo përdorim i materialeve apo riprodhim i tyre pa lejen e botuesit.

ABONIMET

NJË VIT ABONIM NË BORDO
KUSHTON 5000 LEKË/ 40 EURO
KONTAKT: CEL: +355 68 20 69 959
EMAIL: INFO@BORDO.AL

Bulevardi "Dëshmoret e Kombit"
Hotel "Rogner", kati 2
www.bordo.al

letra e editores

Nëntori, dedikuar së bukurës!

Nëntori është kulmi i vjeshtës dhe ky është një numër, që flet tërësisht me ngjyrat e vjeshtës. Që nga kopertina, ku "Miss Universe Albania", Endi Demneri, në prag të nisjes për eventin e madh botëror të bukurisë rrëfen emocionet dhe ndjesitë e saj, shoqëruar me një editorial fotografik tejet sensual.

Eranda Libohova vjen gjithashtu me një editorial mode, duke sjellë tendencat e reja të këtij sezoni, me markat europiane, që tashmë gjenden në Tiranë. Nën këtë petk modeleje, Eranda dëshmon shijen e saj, sesi përtej artit të saj, muzikës, ajo di të jetë në çdo kohë një fashion Icon dhe një frymëzim për të gjithë!

Sonila Çaushi, bukuroshja e "Miss Albania-s" së parë shqiptare, me një karrierë të suksesshme në televizion, si pjesë e departamentit të marketingut, nënë e dy djemve, 23 dhe 13 vjeç, ndan në një bisedë për veten edhe pasionin e saj për modën, ku gjithmonë ka qenë një nga vajzat më të spikatura dhe më me shije të Tiranës.



Një tjetër personazh televiziv për disa, por profesioniste ligjesh për të tjerë, juristja Mira Pogaçi ndan stilin dhe marrëdhënien e saj me të bukurën.

Në të njëjtën temë prezantohet edhe doktor Skerdi Faria, i cili i bashkohet rubrikës së BORDO Men, pikërisht për stilin e tij, si një nga burrat më elegant dhe chic.

Ilda Lumani

Në faqet e Art do të takojmë piktorin e madh Gazmend Leka, me ekspozitën e tij ABEL. Ndërsa, këngëtarja Evi Reçi vjen për projektin e saj të fundit MDO. Apo edhe një intervistë e këngëtarit Argjend Lloga, i cili i rikthehet muzikës me këngë të reja, pas hiteve të tij, si, "Lot i Verbër".

Do të udhëtojmë në faqet e Travel, në Edinburgh me Eda Banon, ndërsa në faqet dedikuar artit të restoranteve vjen chef Gëzim Musliaka me artin, shijen dhe pjatat e tij të mrekullueshme.

Gjithçka ka ndodhur në Tiranë, e gjeni në faqet e eventeve.

Lexim të mbarë dhe shijojeni këtë numër!



OnLine

BORDO ËSHTË NJË PORTAL DEDIKUAR 100 PËR QIND ARTIT DHE MODËS, STILIT TË JETESËS DHE AKTUALITETIT.

NA NDIQNI EDHE NË
Revista BORDO

info@bordo.al | Reklama dhe Promocion **marketing@bordo.al**





Gjikondi

Bulevardi «Zogu i Pare», pallati 103,Tirane.
Cel +355 68 4027360
Instagram: gjikondi_official



ITALOPTIK

RRUGA E DIBRËS PRANË SELVISË,
TEG, KATI I PARË, HYRJA JESHILE, TIRANË
“AIR ALBANIA” STADIUM, TIRANË

www.italoptik.al | **italoptik** | **italoptik1994**

STYLE

BORDO



BORDO IN



FLAMENCO E CHRISTIAN LOUBOUTIN

Shtëpia e modës Christian Louboutin ka krijuar një çantë në formën e një çizmeje, si një kontribut ndaj aktores Rossi de Palma dhe krijuesit të markës, teksa janë duke kërcyer një vallëzim flamenco, ku spikat e kuqja e zjarrtë e frudave dhe padyshim sholla e ndezur e stiletos.



NË ZEMËR TË DOLCE & GABBANA

Ky byzylyk i artë plot 18 karatë nga Dolce & Gabbana është i zbukuruar me safirë, që krijojnë një pamje romantike në formë harku, i cili në të dyja kahet e tij, dallon nga një zemër e kuqe prej rubini e punuar mbi një kornizë delikate dantelle, ndërsa në anën tjetër bie në sy një perlë.



THEKSO BELIN NGA BALMAIN

Duke kthyer kokën tek e kaluara dhe kodet e epokës së artë të viteve 1950, Balmain e gjeti frymëzimin te kjo xhaketë e cila nxjerr në pah linjat, duke kombinuar një pëlhurë me motive vintage, por të realizuara në material xhinsi, duke krijuar një siluetë tërheqëse dhe të freskët.

E KUQE ZJARRI NGA NENSI DOJAKA

Ideal për një mbrëmje, ku eleganca është kodi juaj i veshjes! Ky fustan prej mëndafshi, i dizajnuar nga stilistja shqiptare Nensi Dojaka, ka një pamje provokuese: dekolte delikate të punuar me një transparencë, e cila kryqëzohet nga disa rripa të hollë me të njëjtat tonalitete.





AROMË LIVANDO NGA BURBERRY

Daniel Lee ka bërë tashmë zyrtar debutimin e tij në Burberry, ndaj për të konfirmuar prekjen e tij, zgjodhi të krijojë një palë sandale totalisht ngjyrë vjollcë të dekoruara sipër me një tufë pelushi, duke guxuar me një stil kreativ për koleksionin e parë Vjeshtë/Dimër.



KASTRATI
JEWELLERY

BELLE EPOQUE COLLECTION







IKONAT E BUCCELLATI


Në vitin 1949, Mario Buccellati krijoi një koleksion bizhuterish dhe objektesh të çmuara me porosi të Papa Piut 12 për princeshën Margaret, e cila ju dhurua asaj nga Vatikani, pasi ishte vizita e parë mbretërore britanike në një takim me Papën pas qindra vjetësh.



BIZHUTERI PËR ARISTOKRATËT

Mario Buccellati ishte vetëm 28 vjeç, kur hapi dyqanin e parë pranë teatrit "La Scala" në Milano. Koleksioni i tij debutues bëri përshtypje sidomos tek aristokratët, që ishin edhe blerësit kryesorë. Mjeshtëria e Buccellati-t u bë e njohur në të gjithë Evropën, për bizhuteritë prej ari dhe argjendi.







STILI ITALIAN

Buccellati është vetë Italia! Qysh në fillimet e kësaj marke, krijuesi i saj arriti të gjurmonte stile të ndryshme bizhuterish italiane, duke sjellë në krijimet e tij frymën dhe elegancën e epokës së Rilindjes dhe klasicizmit, elemente të cilat vijojnë të ndiqen ende me fanatizëm nga trashëgimtarët.



KOLEKSIONI "OMBELICALI"

Buccellati u ndikua jashtë mase nga miku i tij, poeti italian Gabriele d'Annunzio. D'Annunzio e shihte bizhuterinë si një metaforë për gëzimin e jetës, ndaj edhe Buccellati krijoi për të koleksionin e gjerdanëve "Ombelicali". Aktualisht, marka është në pronësi të kompanisë japoneze Wako.



MARIO BUCCELLATI
PRINCI I GOLDSMITH

Për më shumë se njëqind vjet, marka italiane e bizhuterive Buccellati është e njohur për unazat me punime të rafinuara, byzylykët, punimin e hollë të argjendit, si dhe mjeshtërinë e sofistikuar të arit. Por, çfarë fsheh historia e krijuesit më të madh të bizhuterive në botë, e cila daton në 1919 dhe vijon me sukses rrugëtimin dhe pas 100 vitesh? Buccellati pati ndikim nga stili venecian, duke përdorur teknikat si: rigato, ornato, tyl dhe dantella të hapur.

EPOKA MODERNE

Buccellati i prezantoi botës koleksionin "Animalier" të përbërë nga 28 karfica kafshësh, të krijuara me perla të stilit barok, krijime të cilat e morën frymëzimin nga disa vizatime të vjetra të familjes. Ndërkaq vetëm në vitin 2001, Buccellati lançoi koleksionin e tyre të parë të orëve në Zvicër.



FRANCHISEE WEEKEND MAX MARA: TIRANË - RR.: DËSHMORËT E 4 SHKURTIT, ND.64, H.3 WEEKENDMAXMARA.COM



MAGJEPËSE

Dantella e zezë është kaq delikate, ka një efekt magjepsës, por edhe një prekje misterioze, sidomos duke i kombinuar me bizhuteri me kristale të bardhë.

1. Çantë nga Chanel 2. Xhaketë nga Gucci 3. Syze dielli nga Givenchy 4. Unazë nga Fendi 5. Balenciaga Vjeshtë/Dimër 2023
6. Fustan nga Rosamosario 7. Vathë nga Chaumet 8. Korse nga Alexander McQueen 9. Body nga Off -White 10. Byzylyk nga Bulgari
11. Jumpsuit nga GCDS 12. Sandale nga Versace 13. Buzëkuq nga Gucci Beauty 14. Pantallona nga Etro

CREED

1760

CARMINA



MAISON DE PARFUM - RR. ABDYL FRASHËRI, LIBRI UNIVERSITAR
MAISON DE PARFUM - KATI 0, TOPTANI
MAISON DE PARFUM - BLV SKELË, VLORË

SHKËLQYESE

Një outfit me efekt shkëlqyes dhe nuanca varaku, por jo vetëm, për një pamje tejet provokuese.



1. Fustan nga Dolce&Gabbana 2. Çantë nga Valentino Garavani 3. Doreza nga Loana Ciolacu 4. Fund nga Rabanne 5. Body nga Vivettah
6. Parfume nga Maison Francis Kurkdjian Paris 7. Varëse nga Simone Rocha 8. Çizme nga Le Silla 9. Fustan nga Jenny Packham 10. Syze nga Versace
11. Gucci Vjeshtë - Dimër 2023 12. Vathë nga Saint Laurent 13. Geta nga Valentino 14. Unazë nga Dior


SOCIETY LIMONTA
TIRANA JU MIRËPRET NË
GALERIA ETC, KATI 1.
+355 4 225 1600
Society Limonta Tirana
www.societylimonta.com
ORIENT-EXPRESS & CO
SOCIETY
LIMONTA



DALLGË THEKËSH

Transformohuni në krijesa mitike, jepini stil pamjes suaj duke u mbuluar me thekë, elemente që rrisin elegancën tuaj, duke krijuar një siluetë të egër, por edhe feminile.

1. Bluzë nga JW Anderson 2. Pudër nga Gucci Beauty 3. Sandale nga Dries van Noten 4. Pallto nga Stella McCartney 5. Syze nga Balenciaga 6. Shall nga Marni 7. Bottega Veneta 8. Fund nga Brunello Cucinelli 9. Çantë nga Gucci 10. Varëse nga Loewe 11. Pantallona nga Galvan 12. Vathë nga Aquazzura 13. Bluzë nga Louis Vuitton 14. Fustan nga Saint Laurent


Estel Jewelry
@esteljewelry
Toptani Shopping Center, Kati 0
+355 69 20 60 504


1


2


3


4


5


6


7


8





ZJARR & AKULL

Eksperimento me dualitetin e dy ngjyrave, një kombinim mes së kuqes dhe blusë, që reflekton pasion dhe qetësi, duke krijuar një simfoni të përsosur.

1. Xhaketë Armani 2. Çantë Outhouse 3. Korse Versace 4. Çantë Mama Bag
5. Çantë Aranyani 6. Fustan Malie 7. Çantë Bottega Veneta. 8. Valerina Ferragamo

MELVINflex
casa dei materassi



MELVINflex
casa dei materassi

RRUGA E KAVAJËS, ND 126,H.12
NJËSIA BASHKIAKE NR 7, TIRANA, ALBANIA

+355 69 4059944
melvinflex_mattresses
Melvinflex


1


2


3


5


11


4


10


9


6


8


5




7

Prekje LIVANDO

Nga tonet e pasura të ametistit deri te nuancat e livandës, tendenca e këtij sezoni ka të bëjë padyshim me vjollcën, e cila reflekton ngado pushtetin e saj. Ndryshe nga nuancat e tjera, ajo që do të vini re është fakti se livando nuk ngjan asnjëherë e mërzitshme, qoftë nëse e zgjidhni si veshje, aksesor apo beauty.

1. Fustan Versace 2. Syze Bottega Veneta 4. Varëse Swarovski 5. Set Āroka 6. Vathë Prakshi
7. Sandale Christian Louboutin 8. Vathë Tory Burch
9. Fustan Dior 10. Sandale Papa Don't Preach 11. Syze Tom Ford


Ja Ku jam me ty!
CREDINS
25 vite



AROMË PORTOKALLI

Nuanca portokalli dhe kungulli, një zgjedhje unike për një pamje pikante: ideale për t'u kombinuar me të zeza.

LALIQUE



Gjikondi

Bulevardi "Zogu i Pare", Pallati 103, Tirane
Tel no +355684027360
Instagram: Gjikondi_official




Miu Miu



Bally

Raf Fine Jewelry



Legend Amrapali





Marc Jacobs

MË ZGJIDH!

Zgjidhni për vjeshtë aksesorët ëndërrues, një paletë nuancash rozë, mente, si dhe lavandër që dhuron pamje super vajzëror.



Gucci



Louis Vuitton



Saint G

Giorgio Armani

HUBLOT

Chopard

TAG Heuer

JACOB & CO

VHERNIER
MILANO

BREITLING
1884

MESSIKA
PARIS

PASQUALE BRUNI

Pomellato

LONGINES

CHIMENTO

S.T. Dupont
PARIS 1872
BE EXCEPTIONAL

COMETE
GIOIELLI

RAYMOND WEIL
GENEVE

MONT BLANC

BARAKA

SALVINI
ITALIAN CONTEMPORARY JEWELRY

Zancan

Gjikondi

BLV "ZOGU I PARE", PALLATI 103, TIRANE. TEL: +355 68 40 27 360

bon TON

Balanconi tonalitetet e lëkurës suaj, duke krijuar një make-up me ngjyra që i përshtaten fytyrës

Hapni çantën e bukurisë dhe zgjidhni fillimisht një korrektor i cili i bën më të errët rrathët poshtë syve. Përpiquni që të shangni lëkurën e zbehtë duke krijuar një ngjyrë sa më natyrale. Pasi të keni krijuar një efekt të njëtrajtshëm, përdorni ngjyra që neutralizojnë parregullsitë: korrektori me nuancë rozë përdoret për të shmangur hijet e errëta poshtë syve, ndëra një primer në ngjyrë portokalli të ngrohtë e ndihmon lëkurën e lodhur, ndërsa një ton i butë livandoje neutralizon të verdhën e tepërt. Në kontrast me kremrat e kamuflazhit të provuar dhe të sprovuar, por të rëndë, korrigjuesit modernë janë jo vetëm më të gjithanshëm në zgjedhjen e ngjyrave, por edhe në thelb. E në fund mund ta mbyllni me një buzëkuq mat, për një pamje e cila do të jetë gjithmonë IN.



1 Sisley **2** Hoda Beauty **3** Make Up For Ever
4 Stila **5** Charlotte Tilbury **6** Eisenberg Paris **7** Givenchy

PERLAS
Travel & Tours

OFERTAT E "PERLAS TRAVEL"

PUSHIME NË SHARM EL SHEIKH!

DUKE FILLUAR NGA
25 NËNTORI
NISJE ÇDO TË SHTUNË

Duke filluar nga 500 €/person
7 NETE
ALL INCLUSIVE

Find us here

PAKETA ME GUIDË
PËR MUAJIN NËNTOR!

PARIS
03 NËNTOR 429€
17 NËNTOR 429€
25 NËNTOR 449€

VIENË
09 NËNTOR 339€
27 NËNTOR 369€

PRAGË
18 NËNTOR 339€

MADRID & BARCELONË
18 NËNTOR 339€
27 NËNTOR 499€

MILANO & LIQENET COMO
25 NËNTOR 339€

PERLAS
Travel & Tours

ADRESA:
RRUGA VASO PASHA, ISH-BLLOKU, TIRANË

LAGJJA "LUIGJ GURAKUQI"
RRUGA: "RINIA", ELBASAN, ALBANIA

www.perlastravel.com
perlastravel@yahoo.com
Perla's Travel & Tour

+355 68 600 4000
+355 69 736 6055
+355 69 769 4047




kthim te NATYRA

Ekstraktet nga bimët kanë përbërës aktivë, formula unike që ndihmojnë në kujdesin e lëkurës dhe flokëve.

Përpos të gjitha risive të shkencës të estetikës, të gjithë kthehemi gjithmonë tek natyra: Gjethet, lulet apo rrënjët e bimëve janë gjithmonë esenca e produkteve më të mira estetike, kujdesit për lëkurën apo flokët. Ndaj po ju sugjerojmë disa produkte me bazë panxhari, xhenxhefili, shelgu alpin apo gjalpë kakaoje, të cilat kanë një potencial të jashtëzakonshëm. Bimët na dhurojnë efektet e tyre magjike dhe krejt natyrale, pasi ato prodhojnë antioksidantë dhe antimikrobiotikë që e ushqejnë lëkurën apo flokët tanë. Numri i lartë i ekstrakteve të marra nga bimët kanë efekte rigjeneruese, ndihmojnë në ripërtëritjen e qelizave të dëmtuara, por edhe u japin më shumë shkëlqim, kjo sidomos te serumet dhe kremrat. Provoni prekjen e tyre magjike!

1 Susanne Kaufmann **2** Babor **3** GISOU 4 Uribe **5** Fable & Mane
6 Augustinus Bader **7** Noble Panacea **8** Cle de Peau


Aparati më i ri
ama® Capsule
Zbuloni ofertat në
shop.amacaffe.com
apo ama Boutique
Caffitaly
System
ama
CAPSULE
INTENSO



1. **Buzëkuq** Nars
2. **Rimel** Carolina Herrera
3. **Buzëkuq** Shiseido
4. **Pudër** Victoria Beckham Beauty
5. **Pudër** Jones Road
6. **Vijëzue**s sysh Haus Labs
7. **Pudër** MAC
8. **Pudër** Chantecaille

Kombinoni grimin tuaj me elemente sa më shumë vezullues

Platinium

Efekt argjendi për cepat e brendshëm të syve: ky është sekreti për grimin tuaj. Nuanca platin dhuron shkëlqim dhe një pamje rrezatuese. Për mbrëmje, provoni të eksperimentoni nuancat e ftohta, frymëzuar nga stili i viteve '90, duke theksuar më shumë qerpikët dhe vetullat me të zezë.



Distributor: Albanian Distribution & Development
fentimansalbania



1. Pudër Dior
2. Buzëkuq Pat McGrath
3. Pudër Chanel
4. Shkëlqyes Glow Sculpt Multi
5. Pudër Hermes
6. Buzëkuq Guerlain
7. Buzëkuq La Bouche

Kjo nuancë i dedikohet saktësisht mollëzave, sepse konturon shumë fytyrën











Perëndim dielli

Jepini lëkurës suaj një shkëlqim të butë përmes një prekje nuance rozë, tonalitete të ngrohta pjeshke ose kajsi. Kjo zgjedhje funksionon shumë mirë në vjeshtë, pasi drita e stinës është më e butë. Në fytyrat më të rrumbullakëta, aplikojeni në formë të madhe C-je, duke filluar nga mollëzat dhe duke u ngjitur lart në drejtim të tëmthave, për një efekt të butë skulpturimi.



VITE KËRKIME, PËR T'U DHËNË FEMRAVE
NJË LEHTËSIM TË MENJËHERSHËM



GINE TANTUM



Sepse kujdesi për zonën intime është hapi i parë i rëndësishëm për një shëndet të mirë.

MEDICAMENTA

ANGELINI

Anti-inflamator, antiseptik anestetik sipërfaqësor.

Pyesni mjekun ose farmacistin tuaj për informacion shtesë.



JACK DANIEL'S

MBJELL PEMË MOLLE NË KOPSHTIN ZOOLOGJIK TË TIRANËS

Kompanitë e mëdha të prodhimit e shpërndarjes së mallrave ose ofrimit të shërbimeve të veçanta, të shndërruara tashmë në brand-e dhjetra apo qindra vjeçare, janë të "blinduar" përballë konsumatorëve të tyre përsa i përket besueshmërisë, ndaj me kalimin e viteve, shpesh herë i kanë orientuar fushatat e marketingut në çështje me rëndësi sociale apo kulturore, siç mund të jetë sponsorizimi i aktiviteteve me fokus artin e kulturën; koncerte, prodhime në kinema, podkaste etj. Së fundmi në Shqipëri, nëpërmjet kompanisë së shpërndarjes MD, Jack Daniel's, në kuadër të promovimit të produktit "Jack Daniel's Tennessee Apple", është bërë pjesë e fushatës së mbjedhjes së pemëve të mollëve në hapësirën e caktuar nga Bashkia e Tiranës, pranë Kopshtit Zoologjik të kryeqytetit, në kuadër të projektit ekologjik "Pyllëzimi i Tiranës". Sipas specialistëve, kjo veprimtari nuk shërben vetëm për rritjen e hijëzimit në parkun e Kopshtit Zoologjik, por edhe për t'i përdorur frutat dhe gjethet si ushqim për lëmurët, strucët, kuajt, ponit, lamat, alpakat etj.

Mbjellja e këtyre pemëve u ndoq nga N/ Kryetarja e Bashkisë së Tiranës, znj. Keti Luarasi, znj. Julinda Dhame, Drejtore e Përgjithshme e Mjedisit dhe Zhvillimit pranë Bashkisë së Tiranës dhe znj. Rudina Hoxha, Drejtore e "Zoo Park Tirana".



KETI LUARASI:

"Jemi të dëshiruar që çdo kompani, çdo entitet, çdo biznes, çdo univeristet të ketë mundësinë t'i bashkohet Bashkisë së Tiranës, qytetit të Tiranës për të vijuar mbështetjen nëpërmjet rritjes së përgjegjshmërisë sociale. Jack Daniel's e ka aktivitetin të shtrirë edhe në vendin tonë dhe kjo nismë ndikon më një frymëmarrje më shumë për qytetin".


#LUTEMIKONSUMONIMEPËRGJEGJËSI
#MENDOGJELBËR
JACK DANIEL'S
Tennessee
APPLE™
#THINKGREEN
#PLEASECONSUMERESPONSIBLY

FASHION ICON

Eranda Libohova

#NGA ILDA LUMANI

#FOTOGRAFIA: LEO ARAPAJ

Eranda Libohova është një nga artistet më të mira shqiptare, për mua personalisht një nga zërat më të bukur. Këngët e saj, thuajse të gjitha superhite, kanë zënë vend në memorien e audiencën, dhe kanë shoqëruar momentet e jetës së çdo shqiptari; nga ato romantiket si "Buzët më ishin tharë" tek ato entuziaste "Rroftë dashuria", këngët me temë sociale "Kthehu për vete për mua", mandej këngët popullore, që nuk ka trevë që s'rri bukur në gojën e Erandës; qofshin këngë tironse, këngë jugu, apo motive Shkodre. Megjithatë, pavarësisht se kjo intervistë sjell Erandën në këtë fazë të karrierës së saj, spunton për këtë editorial e mora nga tjetër arsye. Teksa u takuam pak muaj më parë në një event në Tiranë, ajo që më la mbresë ishte 'look-u' i Erandës. E dallueshme nga të gjithë personat që ishin prezent aty, interesante padyshim, e guximshme dhe frymëzuese. E tillë në fakt ka qenë ngaherë Eranda, me veshjet e saj, në skenën e Festivalit, në klipe, e edhe kur e takon në një ditë të zakonshme. Teksa e sheh nga larg, apo e përshëndet, do të marrësh kohë për të parë me detaje kombinimet që bën. Dhe në të gjitha rastet mund të thuash me bindje se këtë ndërthurje stili, nuk e ke parë diku më parë! Ndaj, Eranda Libohova këtë herë vjen në BORDO si kurrë ndonjëherë, si një Fashion Icon, në një editorial të konceptuar nga vetë ajo!

Sezoni i verës ishte tejet i mbushur me aktivitete për ty. Ka një koncert që doje ta veçoje?

Atmosfera e 'live-it' është adrenalinë që të mban në ajër, kështu që kudo ku kam kënduar kam në kujtesë vetëm fytyra të lumtura, që këndojnë bashkë me mua. Pyetja juaj rreth koncertit sapo i parapriu projekteve të mia, pasi me shpresë që gjithçka të shkojë ashtu siç dua dhe siç unë e kam projektuar në kokën time, vitin e ardhshëm do të realizoj një koncert recital, si dhuratë për të gjithë dashamirësit e mi besnikë ndër vite.

Sërish me Genti Lakon, një kompozitor që keni realizuar disa hite. Fansat tuaj duhet të përgatiten për një tjetër super hit? Ke menduar një klip apo festival për prezantimin e tij?

Me Gentin kam patur shumë bashkëpunime dhe duke qenë se çdo projekt me të ka rezultuar që është kthyer në hit, pse jo të mos krijojmë një tjetër hit. Kam disa këngë të reja në proces e sipër dhe tani të shohim se çfarë impakti do të kenë te publiku, por unë kam bindjen dhe intuitën që do jenë të suksesshme.

Festivali në RTSH të josh? Do ta prekesh Eurovisionin?

Mendoj që klipet janë mënyra më e shpejtë për t'u bërë kënga e njohur, dhe nuk besoj se ka 'urë' më të mirë se këngën ta sjellësh nëpërmjet një klipi të bukur, të kuruar që ajo të kthehet në hit. Festivalin nuk e kam objektiv, dhe ndoshta mund t'ju duket e pabesueshme por nuk e kam patur asnjëherë qëllim në vetvete që do të marr pjesë në Festivalin e Fundvitit që të shkoj në Eurovision. Nuk e di pse, por asnjëherë nuk ka qenë as Festivali, as Eurovisioni në pikësynimet e mia.

A ke një ëndërr në muzikë që nuk e ke realizuar?

Nëse një koncert recital mund ta quajmë ëndërr, atëherë le të jetë kjo. Sepse në gjithë karrierën time, është e vetmja gjë që i mungon portofolit tim. Uroj shumë ta realizoj vitin që vjen. Të kryqëzojmë gishtat! (qesh)

Po një këngë, që thua kam bërë gabim që e kam kënduar?

(Qesh) Po, e kam dhe më vjen për të qeshur sa herë e kujtoj. Është kënga "Më nga mu", që është dhe me klip në YouTube, por unë nuk e kam përfshirë në kanalin tim, sepse nuk e gjej veten fare tek ajo këngë.

Cili është bashkëpunimi më i veçantë që ke bërë?

Bashkëpunimi më i veçantë, ndoshta nuk ka ardhur akoma…

Ndërkohë i je kthyer incizimit për këngë të reja..? Ku dhe në ç'mënyrë do të shohë së shpejti publiku yt?

Publiku im do më shohë së shpejti me tre projekte. Dy këngë janë me dy këngëtarë të muzikës popullore, Valbona Halilin dhe Xhavid Dedej. Të dy këta artistë janë këngëtarë shumë të mirë të muzikës popullore, zhaner që edhe mua më pëlqen shumë dhe e lëvroj në gëzimet e ndryshme familjare të publikut tim. Ndërsa projekti, apo kënga e tretë, që vjen së shpejti është një bashkëpunim me këngëtarin Erik Lloshi.





VESHJA: MARELLA



FUSTANI: PATRIZIA PEPE







ABEL

GAZMEND LEKA SJELL NJË DIMENSION TJETËR TË LUFTËS SË KOSOVËS, PLAGË DHE LOT, TË CILAT NDIHEN EDHE PAS MBI 20 VITESH NGA AJO GJËMË E MADHE E KOMBIT

#NGA OLSI KOLAMI


Në katër dekada krijimtari të vrullshme, pakkush si Gazmend Leka ka shkuar kaq larg në udhëtimin drejt dhomave më të errëta të qenies", thekson kuratori Ermir Hoxha. Ekspozita "Abel" i dedikohet konfliktit më të fundit në Shqipërinë e epërme, në Kosovë, i atij konflikti që u zhvillua në oborrin e shtëpisë sonë. "Abel" ofrohet si kronikë e një morti të asaj pjese të shqiptarisë, të cilës iu desh të paguante një çmim shumë të shtrenjtë lirie. Përtej kufirit të oborrit, "Abel" i dedikohet natyrës njerëzore, që gjeneron gjithnjë konflikte, e paaftë të mësojë nga paqja, nga ajo qetësia e paketuar mijëra herë nga diplomacia. Artisti flet për ndjesitë që e frymëzuan deri në krijimin e këtij cikli me 22 vepra.

Riktheheni në tetor si gjithmonë në stinën e ditëlindjes suaj. Ka ndonjë arsye?

Po! Është e vërtetë! Këto 10 vitet e fundit, unë jam kthyer çdo tetor apo nëntor në galerinë F.A.B. për të çelur ekspozitën personale të radhës. Ka disa arsye pse e çel në këtë periudhë. Pas disa muajsh pune intensive në studio, formohet një cikël i plotë, le të themi aq sa mbajnë ambientet e galerisë F.A.B. Nuk ka lidhje të forta me datëlindjen time. Është koincidencë e bukur, të cilën unë e përmend me shaka mes miqsh, si një dhuratë që ja bëj vetes. E vërteta është se në tetor fillon shkolla. Është muaji, kur në atelie kthehen studentët dhe kolegët artistë. Është muaji, kur Universiteti i Arteve zgjohet pas një letargjie verore. E kam të nevojshme dhe detyrë, që vizitorët e parë të jenë studentët dhe koleget e mi. Mos harrojmë, që ndër vite F.A.B. është galeria më aktive në vendin tonë, duke lënë në hije edhe Galerinë Kombëtare të Arteve. Është galeria që vizitohet më shumë se çdo galeri tjetër në Tiranë, me një aktivitet të ethshëm. Tetori e nëntori janë piku i fluksit. Nga një këndvështrim personal, ekspozitat e mia në çdo fundvit i konsideroj si semaforë, që më orientojnë qartë e prerë, rrugën e rrugicat nga kam kaluar e ku po kaloj. E gjithë energjia njëvjeçare tokëzon pikërisht, këto ditë tetori. Është dita kur monologu im i brendshëm, hyn në sinkron me dialogun e publikut.

Pasi pashë të fundit pikturë nga "Abel", saktësisht numrin XXII, më përshkroi një dhimbje, sikur ajo ndjesia e errët nga një metaforë, u kthye në një makth, ndaj doja të dija si u ngjiz gjithçka ky cikël?

Nga një ekspozitë në tjetrën, gjithmonë ka një periudhë tampon. Është periudhë e rëndë si një gjendje bunace, pasi jam konsumuar shpirtërisht me ekspozitën pararendëse. Ndjej një lloj boshlleku i cili herë-herë më duket sikur nuk do të mbushet, por gjithmonë kapërcehet si periudhë kalimtare shumë e shkurtër. Ndërkohë pikturoj tablo me temë të lirë, për ekspozitat në grup që bëhen çdo vit, sikurse ekspozita "Nëntori" dhe për më tepër ndërtoj cikle me vizatime. Është si një periudhe harlisje. Kur një cikël shkon drejt





fundit, unë rishoh temat që janë në formim e sipër. Janë tema që shkojnë në sinkron me gjendjen time dhe me dëshirën për të shkuar përtej asaj, që bëra një vit më parë.

Po përgatitja një cikël mbi 'Sakrificën', por një takim fare i rastësishëm më fokusoi te "Abeli". Në studio me erdhi për vizitë znj. Rudina Jasini, avokate dhe pjesëtare në grupin e avokatëve të z. Selimi në Hagë. Dëshironte që të njihte ambientin tim, pasi është njohëse e pikturës sime dhe një vizitore e rregullt e ekspozitave të mia. Gjatë bisedës, ndërsa e pyesja se çfarë ndodh në Hagë, mu shfaq figura e Vuçiçit që mbretëron në Serbi, e nuk i ka hyrë ende një gjemb në këmbë, por përkëdhelet si një djalë tinëzar e i llastuar. Mu shfaq një Serbi, që jo vetëm nuk e ka njohur Kosovën, por as të falur nuk ka kërkuar për tmerrin që ndolli mes popullsisë civile. Një çast ishte ai, kur gjithë energjinë dhe imazhet për ciklin "Sakrifica" i kanalizova te "Abeli". Ishte po i njëjti tension, po e njëjta gjuhë shprehje, por e dedikuar. Kaq thjesht filloi. Pastaj piktura ndjek rrugën e vet dhe ka raste, kur edhe ty si krijues të tërheq zvarrë, ndërsa frymon si një organizëm i gjallë.

"Abel" ka një anatomi të tejskajshme, forma dhe eshtra të përkthyera në ngjarje, diku pikëzime gjaku të freskëta, i jeni referuar ngjarjeve konkrete apo jo?

Sigurisht që i jam referuar ngjarjeve të zhvilluara atë vit fatkeq për shqiptarët. Sapo vendosa të bëja ekspozitën "Abel", shfrytëzova materiale që sot i gjen me lehtësi në rrjetet sociale. Kalova nëpër duar shumë fotografi, video dhe intervista të dhimbshme. Lexova materiale të shkruara, siç ishte dhe libri i znj. Sevdije Ahmeti, që ma huazoi Elsa Demo. Çdo gjë e kisha para meje. Mua më ngelej t'i përktheja në gjuhën e pikturës. U përplasën dy pllaka tektonike, Gazi artist dhe Gazi i përditësuar me ngjarjen e rëndë. Nuk ishte e lehtë të shihja e rishihja, çdo ditë pikturat që formësoheshin në sytë e mi. Ishte shumë e rëndë! Nuk di si ma mbajti mideja!

Në mes të sallës pashë Kainin, ndërsa Abeli nën këmbët e tij si qengji i kurbanit, një motiv që nga kohët e lashta, pse kjo simbolikë vëllavrasësish?

Njihet historia e dy vëllezërve, sipas rrëfimit në Testamentin e Vjetër. Nuk është thjesht vrasja e parë e vëllait nga vëllai, por për herë të parë toka u njoh me gjakun që buroi nga krimi. E ndërtova qendrën e ekspozitës, me një kasap që përdor fuqinë e urrejtjes së vrasësit, për të bërë kurban një gjallesë të pambrojtur, siç është qengji. Emri 'Abel' shoqërizohet menjëherë me emrin 'Kain' dhe një njeri i lexuar, e merr menjëherë kuptimin që rrezaton ky simbol arketipal.

Në çdo pikturë, si një ekspert kriminalistike, vendosni piketa me numra, pse ky detaj?


Mes fotove që gjurmoja, më zunë sytë etiketat me numra, të vendosura në trupin e viktimave. Dikush tjetër do ta kishte anashkaluar këtë detaj, që për mua ishte shumë i rëndësishëm. Aty mpiksej fundi i personalitetit të njeriut. Edhe varret kanë emër për t'u identifikuar! Me numra dikur identifikoheshin kryesisht të burgosurit, të deportuarit, atyre që i humbte emri. Është mallkimi i madh, që lë pas lufta. Kur pikturoja etiketat me numra, ndjeja një dhembje shumë të madhe. Unë me mendje iu vija emra.


Vdekja mbizotëron ngado, por në pikturat e fundit shoh ritualet dhe traditat tona, të gjallët para arkëmortit…, ka një lloj respekti para dhimbjes, pse ky kontrast?


Pak elementë përdora në ekspozitë, për ta identifikuar vendin ku ndodhte ngjarja, pasi nuk doja t'i jepja ciklit tone folklorike. Vajtimi përpara arkivoleve të dy fëmijëve, ishte si një shok që më goditi. E pikturova në periudhën e fundit, sepse nuk mund ta duroja gjatë para syve të mi një gjamë të tillë.

Profesor, a do të udhëtojë "Abel" në Kosovë, në vendin prej nga e morët frymëzimin?

Unë dëshiroj shumë që ekspozita të udhëtojë jo vetëm në Kosovë, por edhe përtej. Nuk di t'i jetë kushtuar kësaj ngjarje, një cikël i madh me 22 piktura. Ka shumë vite që ka mbaruar lufta dhe shqiptarët e Kosovës vuajnë ende praninë e fqinjit të keq. E kanë aty në kufi, me hanxhar ngrehur. Sigurisht që piktorët e Kosovës nuk mund ta preknin këtë temë, pasi ata vetë e kanë pësuar krimin në shtëpitë e tyre dhe duhet pak kohë të ruhet distanca për një vepër arti. Këtë detyrë e mora unë përsipër në emër të tyre. Në ekspozitë ftova dhe ambasadorin e Kosovës në Shqipëri, z. Skënder Durmishi me të cilin bisedova, që më pas ta nisnim ekspozitën në Prishtinë. Gjithashtu bisedova edhe me ambasadorin e Shqipërisë në Kosovë, z. Petrit Malaj, për këtë aktivitet që besoj se është i një rëndësie shumë të veçantë. Pata kënaqësinë që ekspozitën "Abel" e vizitoi z. Albin Kurti, të cilin e shoqëroi kuratori Ermir Hoxha. Shpresoj shumë që ky projekt të realizohet.









FAMILJA *ime e jotja* dhe e ARNILDËS

#NGA OLSI KOLAMI

Me përmasa humane pikturat e artistes nga Elbasani përcjellin realitetin, ndalin kohën për të na futur në një dimension që thjesht e perceptojmë, por nuk e njohim.

Të gjithë do të donin të pikturonin familjen e tyre me ngjyrat më të bukura, por ndoshta jo me përmasat e vërteta. Ky perceptim me erdhi krejt natyrshëm, duke parë pikturat e ekspozitës "Familja" të piktores Arnilda Kycyku, e cila përcjell me një realizëm kaq të prekshëm jetën e saj në fshat. Piktura e saj kalon ndërmjet klasicizmit te social-realizmi, siç e quan kuratori Helidon Haliti, me ngjyra të gjalla, personazhe të thjeshtë, por të vërtetë, e shpesh të ndërthurur me metafora që përthyhen këndshëm, në një realitet para të cilit jemi gjendur shpesh, por kemi mundur të marrin vrapin dhe nuk kemi patur guximin për asnjë çast, ta perceptojmë ashtu si Arnilda. Unë shoh veten time aty, sepse jam rritur në fshat. Nuk më duhet aspak të mbyll sytë dhe të imagjinoj, sesi prindërit Arnildës të rraskapitur nga vapa "ngrijnë" për një çast, që vajza të fiksojë sa më shumë detaje mbi telajo. Ata janë të bukur mbi fushën me të gjelbrën e klorofilit, por mbi të gjitha ngjajnë sublimë, sepse e vlerësojnë artin dhe dëshirën që bija e tyre ka për të përcjellë një realitet që jo kushdo do ta kishte pranuar, e më pas pasqyruar përmes pikturës. Por më ngjan se piktorja 26-vjeçare, ka dashur me çdo kusht të zbrazë frymëzimin e saj pas katër vitesh studimesh e mbyllur në atelie minimaliste, ku të vetmet subjekte të gjalla kanë qenë figurantet nudo të orës së anatomisë. Artistja e talentuar nga Elbasani, fill pasi ka kryer studimet e larta është kthyer në vendlindje, aty ku edhe ka gjetur personazhet e saj. Sa herë kthej sytë nga fshati, vendi ku shoh njerëz që punojnë pa u lodhur, aty gjej heronjtë e vërtetë, aty i ka gjetur edhe Arnilda. Ata gjallojnë diku në një fushë të mbjellë me shalqi apo më tutje, si kjo grua me nuanca bohemiane që tërheq një karrocë me kalë, e pastaj një djalosh që plot zell mbledh misrin, duke u rrethuar nga një e verdhë diellore. Arnilda është me fat, sepse ka qenë aty, ka jetuar mes personazheve të saj, herë e dukshme, e shpesh ndihet vetëm penel i saj që ngjyros me butësi telajon për t'i dhënë jetë pikturave. "Një artiste e cila në fakt është adapte, pikërisht për të thënë që arti pikturik është art memec, flet shumë pak, por ka klithma tejet evidentuese në pikturat e saj, edhe pse shpesh tingulli i ngjyrës është pothuajse i heshtur, me një tingull të paqshëm dhe me një subjekt i cili të mbetet në mendje", e përshkruan Helidon Haliti, veprën e piktores nga Elbasani. Ekspozita e saj vjen me mbi 25 punime, ku kryesisht ajo shfaq dilemën ndaj zhvillimit të saj personal, por në kuadër të një familje të konsoliduar, e cila dhe pse e rritur në një nga fushat e Elbasanit në dukje e vetmuar, ka një komunikim të spikatur me natyrën dhe me qenien njerëzore. Pikërisht kjo anë kaq njerëzore i bën akoma më të bukura pikturat e Arnildës, pasi në një mënyrë të thjeshtëzuar, por shumë të fuqishme, ajo na prezanton me një pjesë të botës së saj, ku në qendër është gjithmonë familja, si një pjesë e rëndësishme që e shoqëron përditë. Nuk ka qenë aspak e rastësishme kjo prekje e realitetit për piktoren. Ky kthim mes fushave të pafundme, njerëzve e gjallesave, pikërisht në mjedisin që ka frymëzuar penelin e saj qysh e vogël, i ka shërbyer për të krijuar këtë cikël pikturash, i cili ka thuajse të njëjtën frymë, atë rurale, por që në









momente të caktuara i kalon caqet në heshtje, duke arritur deri te notat e erotizmit përmes nudos. Kuratori Haliti e cilëson pikturën e Arnildës, një realizëm magjik të gërshetuar me një lloj shenje të një perversiteti artistik të emancipimit. Në fakt tre rregullat e arta të realizmit magjik: ekspozimi magjik, rrëfimi dhe përdorimi i fantazisë si një metaforë, janë kaq të prekshme në krijimet e piktores nga Elbasani. Por, në këto elemente, vërej dilemën e saj: të qëndrojë aty në fushat plot diell, për të mbushur telajon apo të vrapojë pas ëndrrës së një vajze të re. Ajo, herë më ngjan e mbushur plot entuziazëm tek mban në mes të këmbëve një shalqi të kuq e të prerë në mes, e herë më duket e vetmuar në autoportrete që ravijëzojnë dukshëm dëshirën për t'ia mbathur nga ai realitet. Kjo këqyrje e imja, përligj dilemat e saj, kur Haliti e përcakton përzemërsisht Arnildën, të përfshirë nga "shqetësimet artistike që shpesh ajo do t'i kalojë me vetminë e saj, që shpesh do t'i kalojë me heshtjen e saj, me klithmat organike të një të reje, e cila ka dëshirë të arrijë sa më lart". Nudot janë të thella, përtej sipërfaqes që anatomia humane shpërfaq. Jo më kot, piktori Haliti dhe njëkohësisht profesori i saj, e cilëson si "një artiste që spikat me studimin ndaj evolimit të vetvetes, një artiste që hesht me zë, por ka tinguj në mesazhet e saj dhe kryesisht në përdorimin e një peneli, jo si skllave e teknikës, por si një dashnore e subjektit dhe e linjës pikante". Arnilda padyshim që është një piktore e talentuar, e cila të prek me ngjyrat e sidomos me dimensionet e punimeve të saj, aq sa të duket se ata njerëz ndodhen pak hapa larg teje, duke zgjedhur një formë kaq origjinale për të hyrë në realitetin e saj. Artistët e dinë që pikturat me dimensione të mëdha janë të bukura, por të vështira, e sidomos kur ato shtrihen në një sipërfaqe 206 x 141, si tabloja e familjes së saj, ku duket se çdo cep i saj reflekton një botë e cila, sado e thjeshtëzuar ngjan, ka një thellësi të papërshkrueshme.

Kjo ishte ekspozita e parë personale e Arnildës, aq personale sa nëse shkoni dhe e shihni, do të keni një dëshirë të papërmbajtshme për ta njohur atë. Por, ajo që pres nga Arnilda në të ardhmen është një cikël tjetër, ndoshta po nga universi ku ajo jeton, për të kuptuar nëse dilemat e saj kanë marrë zgjidhje apo jo. Metropolet janë një mjedis që për shumë krijues të artit janë një makth, një kurth ku fantazia krijuese nuk kalon dot caqet. Ndaj kemi nevojë për vajza artiste si Arnilda, të na sjellin pikturën që vjen e frymëzuar nga peizazhi, me subjekte që gjallojnë dhe nuk janë pjellë e fantazisë, me burra e gra që lodhen për të korrë frutin e punës, njësoj si piktorja nga Elbasani, e cila ja arriti me sukses të vjelë me krenari, frutet e një krijimtarie origjinale.

Arnilda, qëndro në fshat pranë familjes që të do ty dhe artin tënd, rri afër njerëzve që lodhen, por në fund të ditës ajo që i japin shoqërisë është bio, njësoj si krijimet e tuaj. Faleminderit për artin, për pikturën tënde, e cila padyshim që do të lërë gjurmë.



Evi Reçi

Dua të moderoj **“Dancing With The Stars”**



Evi Reçi mungoi këtë sezon në ekran si moderatore, por jo si këngëtare. Kënga “M’do” e solli sërish pranë publikut të saj në muzikë, e kësaj here në një formë ndryshe. Një projekt ideuar që në nisje nga partneri i saj Kledi, e solli Evin më sensuale se asnjëherë dhe impakti ishte pikërisht ai që pritej…

“Mdo” të rikthehu sërish te publiku si këngëtare, si po shkon kënga?
Kënga po shkon shumë mirë, besoj nga ana e audios po pëlqehet shumë kënga dhe shumë videoklipi, sepse për herë të parë dola pak më sensuale ndoshta. Nuk janë mësuar njerëzit me mua, kështu që për momentin po shkon shumë mirë.

Reagimi i Kledit kur pa këngën cili ishte?
Kledi e ka bërë këngën nga fillimi, sepse ishte ai që e ideoi si bashkëpunim. Ai ka dëgjuar demon për herë të parë, pastaj ma ka treguar mua. Është futur shumë në botën tonë tashmë artistike menaxheriale, pasi dëgjuam disa demo ai përzgjodhi këtë dhe kur e dëgjova unë e pëlqeva, kështu që nuk ishte surprizë për të.

Si është të punosh bashkë me partnerin tënd?
Deri tani duket mirë, sigurisht debatet janë ekzistuese gjithmonë, jo kjo bën jo kjo s’bën, por kur tjetri të kupton botën tënde, besoj që gjërat bëhen shumë më të lehta dhe të kuptueshme, aq më tepër kur në një showbiz shqiptar kaotik gjërat janë më të vështira. Një partner që të kupton punën është shumë e rëndësishme.

Për çfarë debatoni më tepër?
Debatojmë zakonisht për punën, që zakonisht janë rrethana të jashtme jo të brendshme, pra ‘filan fisteku’ nuk u soll mirë, nuk u dha projekti në orar, kështu që sherri plas aty më shumë dhe që unë duhet të bëj më shumë palestër ose nuk e di këto gjëra janë. Gjëra pune dhe palestre.

Moderimin apo këngën, cilën ke më afër zemrës?
Muzika është më afër zemrës, është ajo që mua më jep më shumë kënaqësi. Sigurisht, moderimi është pak më i thatë në emocione dhe pse ka shumë emocione brenda. Fakti që unë kur rikthehem, rikthehem me plot fuqinë time do të thotë që muzika ende zë vendin më të rëndësishëm në zemër.

Nga programet që janë aktualisht në televizionet shqiptare, cilin do të bëje me kënaqësi?
Okay, mund ta them, sepse ndoshta e kam provuar si konkurrente. Në 2014-n kam qenë konkurrente në “Dancing With the Stars” ku zura vendin e dytë, kështu që pse jo mos të moderoj një ditë edhe “Dancing With the Stars” ose një talent show muzikor, që besoj do të ishte shumë pranë vetes sime, pranë profilit tim.

A do të merrje pjesë ndonjëherë në një ‘reality show’ (Big Brother)?
Sa herë më është bërë kjo pyetje, sidomos pas situatave të fundit, ma kanë thënë, ma kanë propozuar disi, por nëse më pyet në këtë moment do të thosha jo. Në këtë moment jo, ka ca gjëra që duhet të përfundoj dhe ndoshta një ‘reality’ nuk e di a do t’i bëja mirë vetes, por për momentin do të thosha jo.

Me kë artist do të doje të kishe një bashkëpunim?
Nuk i kam fare këto gjëra. Unë zakonisht bashkëpunimet i kam rastësore. Ndoshta, ndoshta me Aurelën do të kisha qejf të bëja, sepse njihemi dhe personalisht. Aurela Gaçe është super artiste dhe besoj me atë do e bëja. Pastaj, nuk dua të bëj bashkëpunime kot, më mirë këndoj vetë. Bashkëpunimet i dua pak më të menduara, jo sa për të bërë. Kështu që do më shihni rrallë në bashkëpunime.

Me kë nuk do të bëje një bashkëpunim?
Nuk do të bëja bashkëpunim me persona





që mendojnë që janë këngëtarë, edhe pse bëjnë karrierë, edhe pse bëjnë biznes, edhe pse bëjnë shumë klikime më thënë të drejtën. Emra sigurisht nuk mund të them se njihen, por janë ca vlera që për mua janë shumë të rëndësishme për t'i mbajtur në një këngë, por nuk po themi emra.

A ka qenë ndonjë nga këngët tua dedikim?

Këngë dedikim ka qenë "Jeton tek ti", por nuk e kam shkruar unë. "Tjerr" ka qenë, por më shumë jo dedikim ndaj një situate apo një personi, ka qenë një ndjenjë, sepse "Tjerr" erdhi pas tërmetit edhe aty ishte një dhimbje që unë vazhdimisht e përpunoja dhe nuk dilte. "Tjerr" ka qenë në Festivalin e fundvitit, besoj se ka qenë një dedikim ndaj situatës që unë po përjetoja.

Në marrëdhënien tënde me Kledin, kush e bën më tepër ligjin?

Unë jam person që krijoj ndonjëherë kontroll të ekzagjeruar. Nuk dua që asnjëri të mbizotërojë në lidhje. Dua të mbizotërojë mirëkuptimi, kështu që nuk mbizotëron asnjëri. Jemi në balancë të plotë.

A ja kontrolloni telefonat njëri-tjetrit?

Jo, nuk ja kemi kontrolluar dhe pse i kemi me 'pin' dhe 'face control' (qesh). Po arritëm në pikën që të kontrollojmë telefonat, nuk është gjë e mirë.

Në showbiz bën më tepër miq apo armiq?

Miqtë janë të pakët, këtë mund ta theksoj, janë të numëruar në një dorë. Shoh një gjë që nuk më pëlqen shumë, është një mos suport. Edhe nëse të suportojnë është sepse ka një interes nga mbrapa. Nuk i konsideroj armiq, por i konsideroj jo dashamirës ose njerëz jo suportues, kur në fund të ditës kemi të njëjtin hall të gjithë artistët, të njëjtat probleme dhe të njëjtat konflikte ndoshta, të problemeve të të drejtave të autorit. Kështu që, besoj se miqtë nuk vijnë nga bota e showbizi-it.

Cila ka qenë puna jote e parë?

Kam pas dy punë të para. E para fare që kam marrë lekë ka qenë modele, 13 vjeçe në Greqi, si modele flokësh dhe rrobash. Aty ka qenë rroga e parë. Më pas si përkthyese e gjuhës greke dhe italiane në Firenze.

Për ditëlindje do të pëlqente një dhuratë e shtrenjtë apo dhuratë simbolike?

Simbolike absolutisht, mund të jetë një udhëtim, mund të jetë diçka që të më kujtojë diçka që po përjetoj. Dhuratat e shtrenjta sigurisht janë të bukura, duhet edhe t'i vlerësosh, unë nuk është se i vlerësoj shumë.

Cila është fjala që urren më tepër të dëgjosh?

Qetësohu! Lexova diku që asnjërit që i është thënë qetësohu, nuk është qetësuar. Kështu që mos ma thoni fjalën qetësohu, se më shumë nervozohem.

Je më tepër njeri mëngjesi apo darke?

100% mëngjesi. Kam një emision mëngjesi në radio, zgjohem çdo ditë në orën 6 të mëngjesit. Fle shumë herët për shkak të emisionit. Në darkë më zë gjumi shumë herët, në 10:30 11:00 unë detyrimisht duhet të fle gjumë.

Si e kalon fundjavën?

Në varësi të programeve që mund të kem, mundohem të udhëtoj në Austri, mundohem të shkoj në jug, mundohem të kaloj me miqtë e mi, ndoshta kaloj edhe kështu nga këto fundjavat pasive fare në shtëpi. Varion.

Nuk dua që asnjëri të mbizotërojë në lidhje. Dua të mbizotërojë mirëkuptimi, kështu që nuk mbizotëron asnjëri. Jemi në balancë të plotë.

Në përditshmëri, si e kalon kohën e lirë?

Dita ime fillon në orën 6:00, mbaron në 10:00 nga puna. Më pas takimet, xhirimet, intervistat, mund të ketë palestër. Është futur palestra thellë në jetën time, që nuk ma merrte mendja këtë gjë. Shkoj shumë në kinema dhe teatër. Sa herë ka shfaqje dhe filma do të më gjeni aty.

Evi do të shohim këtë sezon në ekran?

Kam disa oferta, kam takuar njerëz të televizionit me propozime të ndryshme. Vlen të theksoj që më propozojnë përditshmërinë. Mëngjesi, pasdite, drekë dhe i falënderoj shumë, por unë kam mendimin që ka ardhur momenti që të bëj diçka tjetër në ekran. Do më shihni, por nëse nuk do të më shihni në ekran do të më shihni diku tjetër, që është si emision, por jo në ekran.

#NGA NADA BIRAÇI
#FOTOGRAFIA: GENT ONUZI
#VENDNDODHJA: COIN



Sonila Çaushi

Gruaja e bukur e marketingut

Ishte viti 2006 kur në një prej bareve pranë Fakultetit të Filologjisë, teksa mëngjeseve konsumonim kafen shoqëruar me bisedat studentore, kalonte shpesh një vajzë a grua te të 30-tat, me flokët e prera shkurt, zeshkane me tipare tipike mesdhetare, fizik të hajthëm, sa indiferente aq edhe koketë njëherazi. Ndërsa 'gruaja misterioze', e cila asokohe jetonte në katet mbi barin e frekuentuar nga studentët bënte rutinën e saj të mëngjesit, kalimi i saj ndiqej nga dhjetëra sy përtej xhamit të barit. Trotuari i ngushtë që të çonte drejt hyrjes së pallatit dukej se imitonte një pasarelë mode, ndërsa zeshkania me flokët e prera shkurt nuk dukej asgjë më pak se një modele. Çdo mëngjes ajo përjetonte një moment 'Malene', pas së cilës edhe vetë Giuseppe Tornatore nuk do të ishte indiferent. Në fakt më vonë mësuam se ajo vërtetë kishte dalë nga pasarela, si pjesëmarrëse në konkursin e parë të bukurisë në Shqipëri. Ishte Sonila Çaushi, një nga vajzat më të bukura të Tiranës në vitet '90, tipar me të cilin dallon ende sot. Edhe pse pjesëmarrja në Miss Albania 1991, e ish-gjimnazistes së Petro Ninit, nuk kaloi pa u vënë re, bukuroshja Çaushi zgjodhi ta mbylli aty karrierën si figurë publike me gjithë ofertat e herëpashershme për t'u bërë pjesë e televizionit. "Jo, prit se më kujtohet që një vit më vonë pranova të bëhem imazh i reklamës së parë në Shqipëri, për produktin që sapo kishte ardhur këtu te ne, Nucrema. Dhe me këtë eksperiencë e mbylla aty karrierën time si vajzë ekrani", tregon Sonila për "Bordo". Edhe pse mori këtë vendim, Soni nuk do të ishte plotësisht jashtë ambientit të televizionit, pasi karriera e saj si eksperte marketingu nisi pikërisht në televizion, në departamentin e marketingut. Një eksperiencë që zgjati për 20 vite e po ashtu gjatë gjithë këtyre viteve për bukuroshen që qëndronte pas shifrave dhe kontratave, ofertat për të qenë pjesë e ekranit nuk kanë munguar asnjëherë. "Duke qenë se kam punuar prej 20 vitesh në televizion, kam patur oferta të herë pas hershme për të qenë pjesë e programeve të ndryshme, por zgjodha të jem pas ekranit. Nuk u josha asnjëherë për t'u kthyer në vajzë ekrani, sepse më pëlqente shumë puna ime në marketing", shprehet Sonila. Por çfarë





#VENDNDODHJA: MAISON DE PARFUM NE COIN

> *"Është një profesion që i përshtatet aftësive të mia dhe zgjodha ta bëj marketingun në televizion, duke patur parasysh që e njoh botën e televizionit që në moshë të vogël. Ka qenë gjithmonë dëshira ime që të jem në televizion, por jo në ekran"*

e shtyu ish-Miss-in të zgjidhte një profesion, që është krejt jashtë jetës publike? "Është një profesion që i përshtatet aftësive të mia dhe zgjodha ta bëj marketingun në televizion, duke patur parasysh që e njoh botën e televizionit që në moshë të vogël. Ka qenë gjithmonë dëshira ime që të jem në televizion, por jo në ekran", vijon më tej rrëfimin e saj Çaushi. Për ata që e njohin, punojnë apo kanë punuar me Sonila Çaushin krahas profesionalizmit dhe saktësisë në profesionin e saj, dëshmojnë se krah hijeshisë fizike, Sonilën e ka shoqëruar gjatë gjithë jetës edhe një shije e hollë në veshje, çka e ka shndërruar në një grua me një stil të pagabueshëm dhe autentik, si aset i shtuar në sharmin e saj. Sonila është ajo shoqja 'fashioniste', me të cilën të gjitha mikeshat këshillohen në WhatsApp për një ide veshje apo kombinimi. Mami i dy djemve, Rei dhe Morgan, modestisht pranon se profesioni që ka zgjedhur nuk ja dikton aspak stilin e veshjes, pasi lehtësisht ajo di të miksojë bukur në një veshje autoritetin dhe modën. Nëse për shumë prej nesh mëngjeset, teksa rrekemi të realizojnë kombinimin e duhur në veshje, kthehet në fustrim, për Sonilën kjo është loja e preferuar. Lidhja me të bukurën duket se ka lindur bashkë me të, dhe Sonila kujton veten fëmijë teksa admironte kombinimet, këpucët llustrafine me taka dhe buzëkuqet e së ëmës:

"Mendoj që stili vjen nga brenda dhe është i lindur. Mund të them që nëna ime ka qenë personi i parë që më ka prezantuar me estetikën dhe dëshirën për t'u dukur bukur. Qasjen e parë ndaj të bukurës, unë mendoj se e kam patur që kur kam lindur dhe kam parë nënën time".

Kanë kaluar 33 vite që kur Sonila Çaushi u shfaq krah bukurosheve të Miss Albania 1991, e që atëherë ndonëse preferoi një karrierë ndryshe nga ajo e dritave dhe prozhektorëve të skenës, Soni mbetet ende Miss dhe e përkëdhelur nga fati për të qenë një grua e bukur në çdo moshë.



JUST B/

Distributor: Albanian Distribution & Development

just_b_water



#NGA NADA BIRAÇI / FOTOGRAFIA: ARBNOR ALLARAJ

Mira Pogaçi, një juriste e suksesshme me një karrierë që pakkush në moshën e saj e ka, vjen në një rrëfim për "Bordo" për sfidat, arritjet, balancat, mëmësinë, si dhe pasionin jashtë profesionit, për terapinë e saj përkëdhelëse 'shopping'….

Mira, cilat kanë qenë sfidat që keni hasur gjatë rrugëtimit tuaj?

Sfida më e madhe ka qenë arritja e balancës midis angazhimeve profesionale dhe kohës së lirë për familjen, veten dhe miqtë. Të punosh pa pushim, me dedikim dhe duke investuar kohë në përgatitje profesionale, ka ndikuar dhe në stilin e jetës. Sot mbaj disa pozicione e tituj profesionalë apo publikë, të cilat krahas kënaqësisë, vijnë me ngarkesë, përgjegjësi dhe stres, dhe kjo kërkon punë me veten që këtë ngarkesë mos ta transmetosh në jetën familjare. Kjo është një sfidë e përditshme.

Çfarë ju ka motivuar dhe ndoshta vijon t'ju motivojë në profesionin që keni zgjedhur?

Rezultatet dhe arritjet janë ato që më kanë motivuar dhe më motivojnë edhe më shumë. Sfidat dhe kapërcimi i tyre gjithashtu më motivojnë. Të punosh në fusha të ndryshme profesionale, dhe të ndikosh pozitivisht në secilën prej tyre, të kesh besimin e bashkëpunëtorëve apo vlerësimin e dëgjuesve, gjithashtu është motivim. Ka plot arsye pse të kesh një karrierë të suksesshme, është motivuese.

Si e balanconi jetën tuaj personale me angazhimet tuaja profesionale?

Organizimi i kohës është opsioni i vetëm. E filloj duke u zgjuar herët në mëngjes, e njësoj veproj edhe në ditët e pushimit, që të marr maksimumin e ditës. Si çdo nënë, pasi përgatis gjithçka për djalin tim, e ndihmoj veten me organizues elektronik të të gjitha formave. Sa shkoj në zyrë bëj 'To-Do' listën time, ku kam përfshirë çdo gjë, është një miks i axhendës së ditës, javës dhe objektivave më afatgjatë si profesionale, familjare, personale, etj.. Dita ime përfundon rreth orës 11:00, ku pasditja është për familjen dhe po kështu shfrytëzoj maksimalisht fundjavat për të kaluar kohë me djalin.

Çfarë këshille do t'i jepnit dikujt që sapo ka filluar në fushën tuaj?

Këshilla ime kryesore është të jetë i përkushtuar ndaj mësimit dhe zhvillimit të vazhdueshëm për të rritur aftësitë. Të mos dorëzohet asnjëherë ndaj sfidave dhe të ndjekë ambiciet, dhe ëndrrat e veta. Gjithashtu, të ndërtojë një rrjet kontaktesh dhe marrëdhënie të mira profesionale, pasi shpesh do të keni nevojë për mbështetjen dhe këshillën e të tjerëve. Dhe se fundmi, edukata dhe mirësjellja të shtrojnë rrugë, që arroganca nuk i shkel dot kurrë.

Të qenit një grua e bukur në profesionin tuaj, si ka ndikuar?

Do të gënjeja nëse do të thosha që njerëzit, në përgjithësi, nuk janë dashamirës ndaj bukurisë, por nuk do t'i atribuoja paraqitjes sime më shumë se 20% rol në arritjet e mia, dhe kjo vlen vetëm për marrëdhënien e punës me televizionin. Në aspekte e angazhime të tjera profesionale, dukja nuk luan asnjë rol përkundrejt përgatitjes.

Patjetër që keni vëmendjen e meshkujve kudo të shkoni; ju bezdis apo e shijoni këtë fakt?

Të jem e sinqertë kontaktet e mia të ditës janë të shumta, gjatë javës janë të shumta, dhe nuk mund as ta konsideroj të paturit vëmendje. Por besoj që me atë që unë përfaqësoj në komunikim, në marrëdhënie me njerëzit, në profesion, kam mirësjelljen e të gjithë personave që takoj, qoftë meshkuj apo femra.

Ju kemi parë që i kushtoni shumë rëndësi dukjes suaj dhe shpesh preferoni të qëndroni larg kostumeve të ftohta dhe autoritare…

Pavarësisht se çfarë përfaqësoj, mendoj që është veçori, jo vetëm e imja, por e çdo femre përpjekja për t'u kujdesur për 'look-un' e saj dhe të duket sa më e hijshme. Është

> *Do të gënjeja nëse do të thosha që njerëzit, në përgjithësi, nuk janë dashamirës ndaj bukurisë, por nuk do t'i atribuoja paraqitjes sime më shumë se 20% rol në arritjet e mia, dhe kjo vlen vetëm për marrëdhënien e punës me televizionin. Në aspekte e angazhime të tjera profesionale, dukja nuk luan asnjë rol përkundrejt përgatitjes*

një dëshirë shumë legjitime e të gjithave ne, kurdoherë që nuk ka tepri.

Duket se keni gjetur një balancë mes stilit të veshjes që jua dikton profesioni dhe shijes suaj personale?

Mundohem gjithmonë që pa dalë nga etiketa, në çdo lloj veshje apo okazioni, të përfshij pak nga stili im personal. Është e rëndësishme të jesh vetja, madje edhe në një mjedis më formal.

Cili stil veshjeje ju identifikon gjatë orarit të punës?

Preferoj stilin 'business casual'. Mendoj që më përfaqëson shumë mirë, si dhe është stil që pranon t'i shtosh elementët e t'u në çdo rast.

Po në përditshmëri, jashtë zyrës së punës?

Sipas vendit bëhet kuvendi. Në veshjet jashtë pune, nuk jam e kufizuar nga ngjyrat apo stilet, një ditë mund të jem shumë sportive, tjetrën klasike, apo 'streetwear' e 'casual', pak a shumë gjithçka sipas momenteve. Por nuk mund ta mohoj, që veshja sportive e ditës së diel është e preferuara ime.

A e quani edhe ju 'shopping' një terapi?

Po, për mua, 'shopping' është një terapi relaksuese, argëtuese, e cila vjen çdo herë me surpriza. Antistres!


Për çfarë shpenzoni më shumë?

Më shumë shpenzoj për veshjet, pasi dua të mbaj një pamje profesionale. Jeta profesionale ka shumë veshje, të zyrës të përditshme, ato të pritjeve zyrtare, të daljeve publike apo dhe të eventeve. Gjithashtu, investoj në aksesorët shoqërues për të gjitha rastet, nga ato që janë të destinuara për të zgjatur gjithë jetën, si ora, deri tek elementët të cilat i përfshijë në garderobë, si trendi i momentit.

TEOXANE

SJELL NË SHQIPËRI

DR. SHADY ISMAIL



NJË EMRAT MË TË MËDHENJ TË MJEKËSISË NË BOTË!

Pak ditë më parë në Tiranë mbërriti një nga emrat më të famshëm të kirurgjisë plastike në botë, Dr. Shady Ismail. Zoti Isamil është një kirurg plastik me më shumë se 12 vite përvojë në mjekësinë estetike. Ai është anëtar i Shoqatës Spanjolle të Kirurgjisë Plastike së Fytyrës (SECPF). Është diplomuar me Master Shkencor në Dermatologji nga Universiteti Cardiff, në Mbretërinë e Bashkuar. Është CEO dhe themelues i Clarite Estetics dhe drejton klinikat e tij në Kajro, Egjipt. Dr. Shady ka qenë folës në më shumë se 70 konferenca, seminare dhe trajnime praktike rajonale dhe ndërkombëtare. Ai ka trajnuar më shumë se 400 mjekë në të gjithë Lindjen e Mesme, si dhe në Evropë. Dr. Shady Ismail aktualisht mban postin e drejtorit të trajnimit të IÇ (International Cosmetic Conference), si dhe është emëruar si KOL (key opinion leader) ndërkombëtar i TEOXANE.
Kompania Megapharme, e cila ka në Shqipëri ekskluzivitetin e linjës Teoxane zhvilloi dy ditë trajnime me dermatologë të Shqipërisë, në një aktivitet, që u organizuam në Marriott Hotel Tirana.

LE TË HYJMË PAK MË NË BRENDËSI TË TEOXANE!

Shumica e mbushësve të lëkurës me acid hialuronik janë një trajtim jo i përhershëm dhe jetëgjatësia e tyre do të varet kryesisht nga lloji i produktit të përdorur, zona e trajtuar dhe faktorë të tjerë të jashtëm, si dieta dhe mënyra e jetesës. Kur bëhet fjalë për mbushësit me pamje natyrale dhe afatgjatë, Teoxane është pa dyshim një nga produktet më elitare që ka krijuar standarde të pakonkurrueshme sa i përket mjekësisë së bukurisë. Trajtimet filler për lëkurën nga Teoxane zgjasin nga 9 deri në 18 muaj dhe gjatë kësaj periudhe, lëkura ka vitalitetin dhe shkëlqimin e një lëkure të shëndetshme e të mirëmbajtur. Për të ruajtur dhe optimizuar përfitimet e procedurës së mbushjes së vijave në fytyrë, Teoxane ka projektuar një sërë produktesh kozmetike bazuar në teknologjinë unike të patentuar nga RHA. Gama prestigjioze premium e produkteve filler, nga kjo markë ndërkombëtare, janë formuluar për të forcuar, hidratuar dhe mbrojtur lëkurën, si dhe për të sjellë më të mirën nga trajtimi me Teoxane. Ky mbushës, që në gjuhën e bukurisë në mënyrë internacionale e njohim me termin 'filler', ka një sërë përfitimesh bindëse për t'u marrë në konsideratë, duke përfshirë krijimin e një pamjeje më natyrale dhe madje edhe me kohëzgjatje më të gjatë, në krahasim me produkte të tjera të injektueshme.
Më konkretisht, filler-i Teoxane trajton: Linjat dhe rrudhat, humbje vëllimi në faqe, buzët e holla, fytyrë e varur, pamje e thellë nën sy, mjekër e varur!



GENEFILL

Genefill është gjenerata e re e mbushësve të lëkurës me acid hialuronik, për një prekje të butë dhe rezultate të dukshme natyralisht. Genefill është mbushësi dermal më i butë, me një gamë të gjerë produktesh që ofron trajtime të personalizuara për lëkurën dhe trupin tuaj. Pavarësisht nëse dëshironi të shtoni volumin, të konturoni kthesat tuaja, të skalitni disa zona ose të përmirësoni veçoritë tuaja të personalizuara në të gjithë trupin, Genefill ka përgjigjen për nevojat tuaja.

ÇFARË E BËN GENEFILL UNIK?

Acidi hialuronik me pastërti të lartë, si dhe molekulat e tij shumë të qëndrueshme më të përfshira në mbushësit dermal Genefill, arrijnë rezultatet më të mira dhe më të sigurta natyrore për vëllim dhe efekt afatgjatë. Linja e produkteve të Genefill bazohet në acidin hialuronik të ndërlidhur me origjinë jo shtazore, i cili shmang transferimin e sëmundjeve dhe zhvillimin e alergjive. Trajtimet Genefill janë pa dhimbje, pa ndërprerje dhe janë krijuar posaçërisht për të siguruar një aplikim të qetë dhe shumë funksional.

TEOXANE
THE EXCELLENCE OF SWISS SCIENCE

BOBDO MEN



Chef GËZIM MUSLIAKA
MARCHESI GOURMET

Joel Edgerton
FYTYRA BURRËRORE **E PRADA**

ABDO FEGHALI
The King of Drift

trend
VISHU **ME STIL** pas të **50**-ave

Këpucë elegante?
Si të zgjidhni idealet!

KREMRAT IDEALË
PËR FYTYRË **TË YNDYRSHME**

bordo
gadget



Google Pixel 8

Kompania Google prezanton telefonin Pixel 8, me teknologjinë e inteligjencës artificiale. Pixel ka lente ultra të gjerë telefoto, e cila kap 56% më shumë dritë, nxjerr fotografi optike 10 herë më të larta dhe aplikacioni Magic Editor falë AI, ju ndihmon t'i afroni fotot tuaja. Telefoni mat edhe temperaturën e trupit të përdoruesit.



Unaza Aura

Një pajisje me shkëlqim, por pa ekran: unaza Oura peshon 4 gramë, rezistente ndaj ujit deri në 100 metra dhe jetëgjatësi baterie deri në 7 ditë me një karikim. Unaza mat hapat, gjurmon rrahjet e zemrës, oksigjenin në gjak dhe orët e gjumit. Çdo parametër shfaqet në pajisjet inteligjente, me të cilat unaza është e lidhur.



Gati Quest 3

Adhuruesit e dimensioneve virtuale do të befasohen me Quest 3, modeli i ri nga Meta i cili vjen e ridizajnuar, duke shtuar një pamje futuristike, kamera me shpejtësi të lartë dhe efekte të reja vizuel, të cilat do të pasurojnë lojërat falë një procesori Snapdragon XR2 Gen 2, duke e kthyer në një eksperiencë unike.

BMW i7

Nëse ende jeni i pavendosur për makinat elektrike, marka BMW do t'ju ndryshojë krejtësisht mendim me modelin e ri i7, një nga automobilat më të mira në treg. Ky model ka një motor elektrik që mundëson të udhëtoni deri në 600 kilometra me një karikim të vetëm, ndërsa në bord ka një ekran kinemaje 31 inç.



Ora GT4

Sfida e Huawei është ora inteligjente GT4, e cila vjen me dizajn të ri që kombinon stilin dhe teknologjinë. GT4 ka përmasa 46 mm dhe 41 mm, e vendosur në kasë çeliku me 4 ngjyra. Ora mat aktivitetin e zemrës dhe ato sportive, frymëmarrjen dhe ciklin menstrual, ndërsa TruSeen 5.5+ përmirëson metodat e të mësuarit.



KREMRAT IDEALË PËR FYTYRË TË YNDYRSHME

Vjeshta është periudha e duhur e vitit, kur mund të identifikoni tipin tuaj të lëkurës, sidomos kur ajo është e yndyrshme. Por, para se të bindeni për këtë, me ndihmën e një vizite te dermatologu, ju mund të identifikoni tipin e lëkurës dhe më pas, jeni gati për trajtimin e duhur, me produktet më të mira. Fakti që në këtë sezon nuk ka temperatura të larta, të cilat e shfaqin yndyrën në zona si balli apo hunda, ju mund ta keni më të lehtë për të gjetur zgjidhjen. Kështilla e parë është të zgjidhni kremra të lehtë, mundësisht me formulë xheli, pa vaj, me efekt mat dhe me përbërës të freskët. Nëse keni një lëkurë jo shumë të yndyrshme, ose nëse ajo shfaqet pjesërisht në disa zona, si balli, mjekra apo hunda, sigurohuni që kremi që zgjidhni të përmbajë një përqindje të mirë përbërësish hidratues, në mënyrë që të mos thahen pjesët ku lëkura është normale. Po ashtu, piketoni produktet që ju rekomandojmë, të cilat janë pa shkëlqim, duke minimizuar dukshëm poret e zgjeruara. E në fund të ditës apo natës, mos harroni të kryeni një pastrim të thellë të lëkurës, pasi vetëm në këtë mënyrë do të reduktoni prodhimin e yndyrës.

ABDO FEGHALI

The King of Drift



Ai ka lindur në një familje të lidhur fort me makinat dhe motorsportin. I ati kishte një ofiçinë dhe pikërisht aty në vetëm pak metra katrorë, lindi pasioni i kampionit Abdo Feghali për makinat e garave. Për familjen ai është Dado, një pseudonim që ja vuri e ëma kur ishte fëmijë, ndërsa për botën është Abdo Feghali, mbreti i driftit.

Me gjithë kundërshtimet e familjes për t'u përfshirë në sporte të tilla, duket se Dados, ndonëse fëmijë, i ishte injektuar në mënyrë të pakthyeshme dëshira e zjarrtë për të qenë në timonin e një makine garash, pasion që shumë shpejt do ta kthente në kampion bote. Piloti libanez Feghali ka qenë në qarqe garash për 25 vite e gjithashtu mban rekordin për sekuencën më të gjatë të driftit në botë prej 11.18 km, duke fituar një Guinness. Abdo 'Dado' Feghali filloi karrierën e garave në vitin 1998, duke u shpallur tri herë kampion kombëtar në rally. Pas suksesit në botën e adrenalinës së garave, Abdo ndoqi pasionin e tij për drifting dhe ka vijuar të bëhet një figurë legjendare në të gjithë botën. Ndonëse në Shqipëri njihet pak, drifting është bërë një nga format më të njohura të sportit motorik, për të gjithë ata që duan të përjetojnë adrenalinën e xhirimit të gomave në pengesa fare të ngushta. Red Bull Albania dhe Abdo organizuan në fillim të muajit tetor garën e parë të driftit në Shqipëri, nëpërmjet një eventi spektakolar.

Kompeticioni plot emocione dhe adrenalinë, "Red Bull Car Park Drift" erdhi për herë të parë në Shqipëri, si pjesë e kualifikueseve botërore në datat 6-7 tetor, në sheshin "Nënë Tereza", në Tiranë. Drifterët më të mirë nga e gjithë Shqipëria dhe Kosova garuan për të shpallur vetëm një prej tyre, si mbretin e driftit shqiptar. Duke dëgjuar zhurmën në sfond të drift-





it që bënin makinat e modifikuara, kompeticioni "Red Bull Car Park Drift", si një ngjarje e paharrueshme e Autosportit, pa pilotët të manovrojnë me pengesat, duke nxjerrë sa më shumë tym që të ishte e mundur për t'i bërë përshtypje 4 gjyqtarëve të jurisë dhe mijëra spektatorëve të kryeqytetit, të cilët ndoqën me emocion këtë garë.


Me gjithë tymin që lëshonin makinat teksa xhiroheshin gomat në sheshin "Nënë Tereza", Abdo Feghali u tregua tejet i gatshëm për të dhënë një intervistë ekskluzive për "Bordo", duke rrëfyer mbresat që i ka lënë Shqipëria dhe dëshirën e madhe për ta zhvilluar sa më shumë sportin e driftit në vendin tonë.

Zoti Feghali, është hera e parë që jeni në Tiranë?

Është hera e tretë. Fatmirësisht, vitin e kaluar pata mundësinë dhe shansin të vija dy herë në Shqipëri. Hera e parë ka qenë në muajin maj dhe pata mundësi të vizitoja pothuajse gjithë Shqipërinë, malin, detin, çdo gjë dhe rashë në dashuri me të. Aty edhe u takova me skuadrën e Red Bull Albania dhe vendosëm të bënim një 'drifting show', dhe shfaqja që bëmë vitin e kaluar, mund ta shihni edhe në Instagramin e Red Bull Albania apo në Instagramin tim, ka qenë e mrekullueshme dhe mezi kam pritur të rikthehem sërish në Tiranë.

Çfarë ju pëlqen më shumë në Shqipëri?

Para së gjithash është kultura, njerëzit, qyteti këtu është shumë i ngjashëm me Beirut, qytetin tim në



Me Red Bull na lindi ideja të organizonim "Red Bull Car Park Drift", që atëherë kemi organizuar evente në të gjithë botën, sigurisht në mjedise të sigurta me të gjitha masat e sigurisë. Kemi krijuar kampionë dhe këtë duam të bëjmë edhe në Tiranë, në Shqipëri

Liban ku unë jetoj. Ju keni detin, keni malin, shkoni të notoni, shkoni të bëni ski në mal…Njerëzit këtu, mënyra si e shohin motorsportin është ajo çfarë unë vlerësoj shumë. Të gjithë e dimë se motorsportet dhe veçanërisht drifting është një sport i ri në Shqipëri, dhe dua të bëj atë që kam bërë për 14 vite në gjithë botën, për të krijuar një kulturë drifting, brenda një mjedisi të sigurt me të gjitha masat e sigurisë. Dua që njerëzit ta kenë parasysh se drift mund të bëhet vetëm në ambiente të krijuara enkas për drifting, jo në rrugë publike, nuk mund të 'çmendesh' në rrugë publike.

Sa i përket masave të sigurisë në drifting, sa i sigurt është ky sport?

Para së gjithash, ti duhet ta kesh parë që të gjithë pilotët vendosin rripin e sigurimit dhe helmetat në kokë dhe sa i përket driftit që bëmë këtu, nuk bëhet fjalë për një trajektore me një shpejtësi të madhe, siç ne e bëjmë zakonisht. Unë jam një pilot rally dhe ne zbresim nga mali në kodër; atë mund ta quaj pak të frikshme apo pak të pasigurt, aty mund të ndodhë ndonjë incident apo dëmtim. Ndërsa në këtë drift është gjithçka e sigurt, asgjë e keqe nuk mund të të ndodhë.

Çfarë mund të na thuash më shumë rreth "Red Bull Car Park Drift"?

Unë e kam organizuar "Red Bull Car Park Drift" në vitin 2008, kur bashkë me Red Bull na lindi ideja të organizonim këtë lloj gare. Që atëherë kemi organizuar evente në të gjithë botën, sigurisht në mjedise të sigurta me të gjitha masat e sigurisë. Kemi krijuar kampionë dhe këtë duam të bëjmë edhe në Tiranë, në Shqipëri. Vitin e kaluar e pashë që drifting ishte diçka e re në Shqipëri dhe mesa pata mundësi i ftova sportistët të uleshin pranë meje, dhe unë të pilotoja makinat e tyre të shihnin si bëhet drifting. Nëpërmjet rrjeteve sociale më vinin herë pas here video dhe pyetje të shumta, ku shoferët më pyesnin se si mund të përmirësohen, çfarë duhet të bëjnë. Jam shumë krenar që këtë vit shoh një nivel shumë më të mirë të drifterave dhe makinave të tyre.

Si e shihni të ardhmen e drifting në Shqipëri?

Gjithçka varet nga klubet, federatat, Red Bull dhe sa do të kontribuojmë të gjithë ne për ta bërë më mirë. Nga ana e Red Bull në Shqipëri dhe ana ime, mendojmë se kemi bërë më të mirën. Tani me shpresën se do të futen në rol edhe qeveria, ndoshta Ministria e Sporteve që ta vijojmë këtë ngjarje sportive. Disa vende në Lindjen e Mesme kanë 14 vite që e bëjnë këtë show sportiv, kështu që shpresojmë që edhe në Shqipëri të rikthehemi sërish, që të rritet kjo kultura e makinave dhe ta bëjmë të sigurt, kjo është shumë e rëndësishme. Disa njerëz mendojnë se drifting është i rrezikshëm, por është krejt e kundërta. Këta djem e dinë çfarë bëjnë, në një zonë të sigurt, janë të edukuar dhe shpresojmë të bëhen ambasadorë për të tjerët.

BLOOM INTO YOURSELF, **BLOOM INTO YOUR YOUTHFUL SKIN!**

Me ardhjen e pranverës shtohet edhe më tepër nevoja që kemi për tu kujdesur për veten. Ne në Velur Spa jemi të lumtur t'ju prezantojmë me një nga shërbimet më të përparuara të lëkures, trajtimin me dioksid karboni.

Ky trajtim është i vetmi në llojn e vet i cili përdor dioksid karboni të lëngshëm. Një trajtim i sigurt, jo invaziv dhe pa kohë rikuperimi.

Në Velur Spa do të gjeni Carboxy Therapy për trajtimin e fytyrës me rezultate fantastike lifting, anti-akne, rritje të elasticitetit të lëkurës si edhe për kontrollimin e poreve. Por edhe Carboxy Therapy per trajtimin e trupit duke targetuar kryesisht celulitin, rritur elasticitetin e lëkures si dhe trajtimin e strijave!

Vizitoni faqen tonë në instagram dhe facebook per tu njohur mbi ofertat promocionale për trajtimin e ri Carboxy Therpay!

CO_2

VELUR
SPA

Rruga "Sami Frashëri", Qëndra Tregetare Metropol || info@velurspa.com || velur.spa@gmail.com || +355 69 20 32 900 || 04 2222550

Rikthehet ARGJEND LLOGA



Kësaj here "Bordo" do të sjellë pranë lexuesit një artist të munguar prej shumë kohësh në skenë dhe në ekran. Bëhet fjalë për Argjend Llogën, këngëtari i cili me hitin e para dy dekadave "Loti i Verbër" bëri për vete fansa në mbarë botën. Ai jeton prej 13 vitesh në Nju-Jork dhe rikthehet në Shqipëri për të realizuar dy këngë të reja. Edhe pse në gjithë vitet e emigrimit artisti nga Struga ka ardhur shpesh në Shqipëri, herë për pushime, e herë për projekte të ndryshme, këtë rikthim në muzikë ai e quan si, 'rikthimi më i sigurt'.

Si është ndërtuar jeta juaj në Amerikë?

Fillimisht unë kam emigruar në Amerikë duke menduar për të ardhmen e fëmijëve, që ata të zhvillohen atje me të gjitha mundësitë që ai vend të ofron. Sigurisht që fillimi ka qenë i vështirë, me sakrifica, jam marrë me punë të ndryshme, derisa krijova lidhjet e mia për t'ju përkushtuar muzikës. Ky kalvar sakrificash prej emigranti ka zgjatur për pesë vite, dhe vetëm më pas m'u krijuan kushtet dhe mundësitë për t'u marrë me muzikën. Rrugën e muzikës atje e gjeta me mbështetjen e disa miqve të mi në SHBA, njëri prej të cilëve është Kujtim Fundiqi, pronar i një lokali në Bronx, Nju-Jork, vend ku prej 9 vitesh punoj si menaxher dhe këngëtar, ku shpesh ftoj artistë të ndryshëm nga Shqipëria, duke dhuruar mbrëmje të bukura për publikun shqiptar që jeton aty.

Çfarë ju bën më shumë përshtypje sa herë që riktheheni në Shqipëri?

Ndihem mirë sa herë kthehem në Shqipëri, ka nisur të vlerësohet puna e artistëve dhe jam shumë i kënaqur në këtë pikëpamje. Pikërisht kjo gjë më bën të rikthehem me shumë dëshirë në Shqipëri.

Vini shpesh në Tiranë? Çfarë është Tirana për ju?

Vij shumë shpesh, disa herë në vit. Kam miq këtu në Tiranë dhe arsyeja e ardhjes, përpos kënaqësisë, janë edhe bashkëpunimet me artistët që jetojnë këtu. E dua shumë Tiranën, Shqipërinë, e dua kulturën dhe edukatën që shoh këtu.

Në aspektin familjar ju gëzoni statusin e gjyshit. Çfarë ndjesie është?

Është një ndjesi e jashtëzakonshme. Unë jam gjysh i një mbese, që quhet Treva. Ne që jetojmë jashtë trevave tona, jemi shumë të lidhur me emrat shqiptarë, kështu që e gjithë familja ra dakord që mbesa të merrte këtë emër 100 % shqiptar.

Ju këndoni për të gjitha trevat shqiptare, ku e keni ndjerë më shumë ngrohtësinë e publikut?

Kudo ku ka shqiptarë, por në Shqipëri mund të them që jam ndjerë gjithmonë i vlerësuar, në Shqipëri e ndjej veten artist më shumë se kudo tjetër.

A keni ju një artist të preferuar nga i cili frymëzoheni?

Janë disa këngëtarë shqiptarë që i vlerësoj shumë. Është Aurela Gaçe, Eli Fara, Merita Halili, Fatmira Breçani…

Shqiptarët e diasporës janë shumë të apasionuar edhe pas televizionit shqiptar. Ju çfarë ndiqni më shumë, a keni një program të preferuar?

Po, e vërtetë! Ne i ndjekim shumë programet shqiptare. Sa herë mundemi dhe na përputhen oraret shohim TV shqip. Unë personalisht, më shumë preferoj të dëgjoj këngë shqip dhe ndjek shpesh kanalet që shfaqin muzikë shqiptare.

E keni menduar ndonjëherë të zhvendoseni përfundimisht në Strugë apo Shqipëri?

E kam menduar shpeshherë. Unë edhe ëndrrat i shoh vetëm në atdhe. Mirëpo duhet pranuar realiteti që fëmijët atje janë stabilizuar dhe po realizohen çdo ditë e më shumë, e për hir të tyre për momentin edhe ne duhet të qëndrojmë atje. Me mundësitë që na ka dhënë Amerika dhe me dashurinë që ndjejmë për vendin tonë Shqipërinë, them se do ta ndaj jetën mes dy vendeve.

Pas kaq vitesh në Amerikë, jetoni më shumë si një amerikan atje, apo i ruani me fanatizëm traditat shqiptare?

Kur kemi shkruar në fillim, shihja fëmijët që ndiqnin më shumë televizionet e huaja dhe në shtëpi nisën të flisnin më shumë anglisht. Të them të drejtën, jam prekur dhe e kam përjetuar shumë keq atë periudhë. Unë që kam kënduar gjithë jetës këngë shqip, këngë patriote, më dukej e tepërt që në shtëpinë time të flitej gjuhë e huaj. Që atëherë jua vura kusht fëmijëve, që në shtëpi do të flitej vetëm shqip, në të kundërt do t'i ktheja mbrapsht në Strugë. Madje edhe kanalet e huaja, për një farë kohe, jua ndërpreva në shtëpi. Anglishten e përdornin në shkollë, në shoqëri, në punë…s'ishte e nevojshme të flitej edhe në shtëpi anglisht.

Jua vura kusht fëmijëve, që në shtëpi do të flitej vetëm shqip, në të kundërt do t'i ktheja mbrapsht në Strugë. Madje edhe kanalet e huaja, për një farë kohe, jua ndërpreva në shtëpi. Anglishten e përdornin në shkollë, në shoqëri, në punë...s'ishte e nevojshme të flitej edhe në shtëpi anglisht.



PIPERO DENTAL STUDIO

DOKTORESHË ERISELDA PIPERO

E SPECIALIZUAR NË KIRURGJI DHE IMPLANTOLOGJI

SHËRBIMET QË DO TË GJENI:

- Terapi
- Kirurgji dhe implantologji
- Ortodonci
- Periodontologji
- Pedodonti
- Filler botox
- Mesoterapi
- Dermapen 4
- Zbardhim me lazer

DHE RISIA E FUNDIT E LAZERIT ALFA FORMATK" PËR EPILIMIN DEFINITIV SKIN REJUVENATION DHE LARGIMIN E NJOLLAVE

ADRESA: RR. "NDRE MJEDA", REZIDENCA ALBA, KATI 2, TIRANË

+355 67 20 52437

me stilin e doktor Skerdit



#NGA NADA BIRAÇI

Skerdi Faria, nuk është vetëm një doktor i sukfushën e kirurgjisë plastike, por edhe sesshëm në një burrë që dallon për shijen e mirë në veshjet e tij. Edhe pse mund të mendohet se dëshirën për t'u dukur bukur së jashtmi ja ka injektuar profesioni i tij, duket se pasioni për estetikën dhe të bukurën ka lindur bashkë me të...

Skerdi çfarë apo kush ka ndikuar në stilin tuaj të veshjes?

Gjithmonë më ka pëlqyer e bukura dhe estetika, edhe në veshje. Kur isha i vogël dhe i varfër gjatë komunizmit, përpiqesha të vishja rroba të bukura e që më rrinin mirë, duke u përpjekur edhe të kombinoja sadopak ngjyrat me aq sa kishim mundësi. Mbaj mend një herë që mami më bleu një palë tuta të mëdha, pasi në dyqan nuk kishte masë tjetër për mua. Ai model tutash më pëlqente tepër, por më rrinin të gjera dhe mamaja nuk e vriste shumë mendjen të m'i ngushtonte, pasi kishte edhe punët e shtëpisë. Mua më ishte fiksuar që do t'i vishja menjëherë, ndaj me një gjilpërë dhe pe i qepa e i ngushtova vete nga brenda, pasi nuk kishim makine qepëse atë kohë. Mund të imagjinohet se sa "të bukura" dhe stilizuara i kam nxjerrë. Këto vitet e fundit, me siguri ka influencuar edhe profesioni dhe puna që bëj. Jam në kontakt të vazhdueshëm me shumë njerëz dhe përpiqem të paraqitem në mënyrë sa më elegante. Edhe kur vesh një bluzë e një palë pantallona, zgjedh dy ngjyra që përshtaten me njëra tjetrën.

Blerjet e veshjeve i bëni vetë, apo ju ndihmon bashkëshortja? Ku bëni 'shopping' më së shumti?

Nuk bëj blerje të shumta, pasi shpesh nuk kam shumë kohë për 'shopping'. Meqenëse banoj në Romë, 'shopping' bëj zakonisht në një qendër tregtare 'outlet' afër Romës. Zakonisht marr pak a shumë të njëjtin stil veshjeje, duke u përpjekur të përshtas e kombinoj ngjyrat. Ndonjëherë edhe bashkëshortja blen veshje për mua, duke qenë se tashmë m'i njeh mirë shijet. Sa i përket kostumeve, ka vite që i bëj me porosi te miku im stilist Altin Mici. Ai më tregon stofat e rinj që ka në dispozicion dhe unë zgjedh vetëm copën. Brenda pak ditësh kam gati kostumin e ri, që Altini asnjëherë nuk harron të ma shoqërojë edhe me kravata të ndryshme.

Marka juaj e preferuar?

Të them të drejtën, nuk kam preferenca të veçanta për ndonjë markë, por do të veçoja Zegna e Boss, pasi më qëndrojnë më mirë në trup.

Cila është blerja më e shtrenjtë që keni në garderobë?

Nuk preferoj veshje të shtrenjta dhe eksklusive të markave të mëdha. Veshjet më të shtrenjta janë kostumet me jelek, maksimumi 500 euro.

Po më e lira?

Dikur kam blerë veshje shumë të lira, por edhe kohët e fundit kam marrë bluzë nga 20-30 euro.

Nisur nga pamja juaj, një burrë gjithmonë i kuruar dhe i veshur me shije, do të thotë se nuk jeni stereotipi i burrit veshjet e të cilit zënë një cep modest në dollapin e çiftit tuaj?

Nuk kam ndonjë garderobë me shumë veshje, e për më tepër të shtrenjta. Kam një dollap normal për mua, e një për bashkëshorten. Stili i jetës dhe i veshjes nuk ka ndryshuar shumë vitet e fundit. Për fat të mirë kam ruajtur të njëjtën formë të trupit e të peshës, dhe përdor edhe veshje që kam blerë para shumë vitesh. Nuk jam tip që rend pas modës e të rejave, jo se nuk më pëlqejnë, por nuk e konsideroj të nevojshme, e as nuk kam shumë kohë të lirë në dispozicion.

Në trajtimet apo ndërhyrjet tuaja, preferoni të bëni një ndërthurje të përkufizimi tuaj për bukurinë fizike me perceptimet e pacientit, apo ja lini në dorë zgjedhjen pacientit?

Unë dhe bashkëpunëtorët e mi kemi një vizion dhe qëllim të përbashkët e tashmë shumë të konsoliduar në Keit. Refuzojmë kategorikisht ekzagjerimet dhe përpiqemi t'i shpjegojmë pacientit, se cili do të ishte rezultati më i mirë i mundshëm për t'u realizuar, pa shpërfytyruar pamjen e tij estetike, qoftë të pjesës së fytyrës e trupit të operuar, por edhe të harmonisë në tërësi.

Për shkak të profesionit, jeni lidhur në mënyrë të pashmangshme me të bukurën. Sa rrezikon dikush që merret me kirurgjinë plastike të kthehet në sipërfaqësor?

Nuk besoj aspak që ky profesion influencon në thellësinë e mendimit të një profesionisti. Përkundrazi, duke patur kontakte të shumta me njerëz nga më të ndryshëm, ndodhem përballë jo vetëm me kërkesat e tyre për pamjen estetike, por njoh edhe problematika psikologjike, apo këndvështrime të larmishme për të bukurën apo botën në tërësi. Përballem me emocione të forta pozitive të pacientëve të lumtur apo në raste të rralla, edhe me reagime jo të mira kur rezultati nuk është i dëshiruari. Kjo më bën të njoh gjithmonë e më tepër njerëzit, e të reflektoj në thellësi të shpirtit tim.

Skerdi, një doktor që shpesh me vetëdije bëhet pjesë e memeve në rrjetet sociale; kjo ka qenë një strategji marketingu apo jeni i tillë edhe në jetën e përditshme?

Nëse vendos që të



jesh i pranishëm në rrjetet sociale, herët a vonë dikush do të bëjë shaka me ty. Të gjithë, kush më shumë e kush më pak, jemi 'viktima' potenciale të memeve. Sa herë që shoh meme të bukura rreth meje, zbavitem shumë dhe qesh me të madhe. Ka raste që edhe e teprojnë ndopak por nuk mërzitem, pasi e di që e bëjnë pa të keq dhe është thjesht një mënyrë hokatare e të shprehurit. Edhe vetë shpesh jam autoironik me veten time, sidomos kur të tjerët harrojnë të bëjnë ironi me mua. Nuk është strategji marketingu e organizuar nga Keit, për sa kohë janë të tjerët që bëjnë meme rreth meje, por sidoqoftë është një mënyrë interesante për të shpërndarë imazhin tim, ndaj e konsideroj si diçka pozitive edhe për punën tonë.

Standardet e bukurisë ndryshojnë me kohën; po për ju personalisht çfarë tiparesh fizike duhet të ketë një grua që të cilësohet e bukur?

Nuk kam ndonjë standard të veçantë bukurie për sa i përket pamjes së jashtme, çdo femër ka tipare të bukura për t'u vlerësuar. Por nëse do të duhet të zgjidhja për të dhënë një vlerësim estetik, do të preferoja një femër e cila ka edhe "defekte" të vogla, por në tërësi ka një sharm dhe karizma që e shpreh jo vetëm me pamjen estetike, por edhe me sjelljen, intelektin, ecjen, lëvizjet, veshjen, e mbi të gjitha shpirtin e karakterin e saj.

Si është raporti femër/mashkull që vijnë në klinikën tuaj?

Besoj se mesatarisht janë 70% femra e 30% meshkuj.

Pse kjo përqindje? Mund të themi që janë vajzat dhe gratë, ato që kanë më shumë pasiguri për pamjen e tyre të jashtme?

Mendoj se mbi të gjitha është çështje e lindur e gjinisë femërore, dhe jo pasiguri karakteriale. Femra ka dy kromozome X, ndërsa mashkulli një X e një Y. Me siguri aty tek ai kromozomi X i tepërt, fshihen sekretet e shijes dhe ekzigjencave estetike, që femrat kanë më tepër se meshkujt, pa dashur këtu të përgjithësoj. Ndryshe nuk kam si ta shpjegoj që një vajzë 3 vjeçe vesh rrobat, këpucët, merr makeup-et e mamit dhe fillon e llastohet para pasqyrës, kur një djalë i të njëjtës moshë e ka mendjen të luajë me makina e me top. Ndoshta është një idiotësi e madhe nga ana shkencore kjo që them, por është realitet.



Vishu me stil **pas të 50-ave**

Të vishesh bukur pas moshës 50-vjeçare, megjithëse mund të mbulojë vetëm një aspekt të jashtëm të personit, është një praktikë thelbësore. Nëse te të 30-at lejohet gjithçka dhe kur je 40 pak nga pak, ke ende kënaqësinë për të minimizuar moshën, pasi kalon pragun e të pesëdhjetave nuk ka më justifikime. Por, në ditët e sotme shumë burra mund të reflektojnë një pamje rioshe dhe me stil. Si veshjet e ditës, ashtu edhe ato të mbrëmjes duhet të studiohen deri në detajet më të vogla. Por mos u shqetësoni: nuk është aq e vështirë të dukeni plot stil nëse jeni mbi 50 vjeç, përkundrazi. Rregullat që duhen ndjekur janë të pakta, por të rëndësishme. Pesëdhjetëvjeçarët kanë një trup i cili i lejon vetes të përdorim veshje të stileve të ndryshme. Ky truk është një mënyrë për të rifreskuar stilin tuaj, pa patur nevojë të zgjidhni veshje shumë ekstravagante. Një xhaketë sipër një t-shirti prej pambuku, pantallona kadife dhe një palë çizme kamoshi, janë një zgjedhje ideale që ul dukshëm moshën, duke reflektuar një frymë rok e bohemiane, siç ndodh me aktorin 58-vjeçar, Keanu Reeves. Po kaq rëndësi ka zgjedhja e ngjyrave pas të 50-tave. Sekreti zgjidhni tonalitete të njëjta. Një xhaketë dhe pantallona të kombinuara me një këmishë të së njëjtës nuancë, siç ka zgjedhur 56-vjeçari Vincent Cassel, i japin pamjes uniformitetin. Këshilla tjetër është stili casual. Atlete dhe xhaketë lëkurë janë shembulli më i mirë, megjithatë pas të 50-ave, ngjyrat e errëta do të ishin të duhurat për pamje të relaksuar. E zeza? Gjithmonë një garanci, të paktë këtë e konfirmon Jude Law. Kafe e errët dhe jeshile e errët funksionojnë mirë, por nëse doni të rrisni nivelin e elegancës, qëndroni te nuancat e errëta. Për ata, si aktori 55-vjeçar Daniel Craig, që nuk dalin dot nga stili elegant, një kostum ngjyrë kremi kombinuar me nuanca gri, janë zgjedhja e përkryer për të reflektuar stilin e rafinuar.







Këpucë elegante?
Si të zgjidhni idealen!

Një veshje nuk është kurrë perfekte pa ato. Le të flasim për këpucët elegante për meshkuj. Qofshin raste formale ose casual, një pamje e përshtatur me pantallona të ngushta dhe një këmishë, mjafton të keni një palë këpucë elegante për të ndryshuar gjithçka. Sepse këpucët klasike e bëjnë çdo kombinim më të lehtë. Po çfarë duhet të dini për të njohur, vlerësuar dhe veshur siç duhet një palë këpucë elegante për meshkuj? Para së gjithash, vini re mjeshtërinë e punimit të tyre. Këpucët elegante për meshkuj janë mbledhur kryesisht në grupin e të ashtuquajturave Oxfords, modele me lidhëse që u bënë të njohura në mesin e studentëve të universitetit anglez në shekullin e 19-të. Sa më e hollë të jetë sholla ose tabani, aq më i lartë është koeficienti i elegancës së tij. Kriteri tjetër është se një palë këpucë elegante, duhet të zgjidhen gjithmonë në një nuancë më të errët se ajo e pantallonave, ndërsa çorapet - përveç nëse doni qëllimisht të bini në sy – duhet të kenë ngjyrë të njëjtë me atë të këpucëve. Për puristët e mirësjelljes në raste elegante dhe më formale, këpucët dhe rripat e meshkujve shkojnë absolutisht krah për krah në ngjyrë, stil dhe material. Çfarë ngjyrash duhet të zgjidhni për këpucët elegante? Kjo është një përgjigje e lehtë: gjithmonë e zezë dhe në çdo rast, bluja e errët është shumë e vlerësuar, ndërsa ajo kafe zgjidhet vetëm për kostumet e lehta dhe ato ditore. Këpucët klasike shpesh nuk ndjekin modën, sepse moda shkon pas tyre, por ne po ju sjellim disa sugjerime, të cila do t'ju orientojnë për të piketuar modelet që ju përshtaten më shumë.





Joel Edgerton


FYTYRA BURRËRORE **E PRADA**

Aktori australian që nuk e do vëmendjen, papritur është shndërruar në ikonën mashkullore, fytyra e cila do të jetë busulla orientuese e markës italiane të modës...



Në jetën e tij, aktori australian Joel Edgerton ndjen një ankth të thellë kur përjeton konflikt ose tension. Por në xhirime, ai mund të shkojë pa ju dridhur qerpiku në një mjedis ku mund të bëjë gjithçka, madje mund të ndihet rehat më shumë sesa në jetën reale. Pikërisht në rolin e tij të fundit ka shumë tension: ai përfaqëson një hortikulturist, me një të kaluar të fshehtë. Narvel është i mbuluar me tatuazhe raciste, të cilat i zbulohen audiencës vetëm kur kopshtari heq këmishën e tij. "Mbaj mend që kur i mbajta tatuazhet për herë të parë, ndjeva një lloj fuqie të çuditshme", thotë Edgerton, i cili shfaqet në filmin "Master Gardener", i treti i trilogjisë së filmave të Paul Schrader. Ajo që ndoshta i ka dhënë personazheve të filmit një tjetër dimension, është fakti se secili përfaqëson një njeri të vetmuar dhe të mbyllur emocionalisht, një gjendje e cila vlen për t'i shpëtuar të kaluarës. "Ajo që regjisori Paul Schrader më tha që në fillim ishte të mos bëja asgjë, duhet të lija historinë të fliste me pak fjalë dhe shumë gjendje. Ishte e vështirë, sepse sa më pak aktor të isha, aq më mirë do të ishte për filmin", thotë Edgerton. E pranon se kjo ishte një sfidë vërtet interesante, sepse ai si një aktor kishte frikë se duke mos bërë asgjë, kjo do të ishte e pamjaftueshme, por kur nisën të gdhenden tatuazhet mbi lëkurë, e kuptoi se emocionet nisën të shfaqen natyrshëm. Joel është nga ata aktorë që mjaftohet me pak, sepse pikërisht kështu nisi karriera e tij, nga një rol shumë i vogël në Star Wars: Episode II - Attack of the Clones, e cila ndryshoi karrierën e tij. "Kjo ishte leva ime për në të hyrë Hollywood. E dija që mund të shkoja në Hollywood dhe të thosha se isha pjesë e 'Star Wars', por këtë askush nuk do ta dinte, sepse

PRADA SS24



kisha vetëm 3 minuta rol, por ama kjo ishte një mundësi për audicionet e ardhshme", kujton aktori. Ishte viti 2000, kur ai shkoi në Los Angeles dhe filloi të bënte takime, por njerëzit nuk po e merrnin seriozisht. Gjithsesi, "Star Wars" me të vërtetë i hapi atij një derë për të ardhmen. Edhe sot shumë njerëz e njohin për "Star Wars", pavarësisht se pas këtij roli, ka patur shumë të tjerë. "Gjithmonë e kam patur ëndërr të bëhesha aktor dhe të shihja botën në të njëjtën kohë. Mbaj mend fluturova drejt Tunizisë për të bërë një kinoprovë mbi një Land Cruiser të bardhë, duke duruar vapën e madhe të shkretëtirës së Saharasë. Kisha krah George Lucas dhe e ndjeva atë çast sikur jeta ime po lëvizte në drejtimin që doja". Dhe jeta e tij ndryshoi 360 gradë papritur nga ai rol i vogël.


Edhe pse kishte fatin që i vëllai Nash, ishte tashmë një aktor i afirmuar, për Joel duhej të punonte dyfish, një sfidë vëllazërore e cila kishte nisur që kur jetonin ende nën të njëjtën çati. Nuk e fsheh se i vëllai më i madh ka qenë paksa skeptik, jo për aftësitë, më shumë sesa për faktin, se siç ndodh zakonisht, të vegjlit ndjekin gjurmët e më të rriturve si një sfidë. Kujton se në një sheshxhirim u përplas me një makinë dhe e pa veten të vdekur në rol. E përjetoi kaq pak atë moment në film, aq sa ditët e ardhshme kur nuk shkonte në xhirime, gati u dorëzua për të ndjekur ëndrrën e tij. Kujton se fraza që Nash i tha ishte: "Një aktor nuk duhet të ankohet për diçka që nuk ia vlen. Edhe atëherë kur roli i tij zgjat pak sekonda, sepse kjo copëz filmi, sado pak të duket ka gjithmonë një qëllim madhor". Tani që ka një karrierë të gjatë në filma, si: King Arthur, The Thing, Warriors apo The Great Gatsby, jeta e tij ka ndryshuar, por jo dhe aq në jetën personale. Edgerton vërtet po jeton ëndrrën e shumë njerëzve; duke ecur në tapetin e kuq, por nuk është ajo që dëshiron vërtet. "Jeta e aktorëve duket magjepsëse, por ka më shumë se kaq. Mediat dhe tabloide ndoshta mendojnë se aktorët kanë ego çeliku, por edhe ne jemi njerëz dhe lëndohemi. Të qenit në sy të publikut ka një çmim", thotë ai. Ai ruan pa kushte privatësinë e tij, ndaj kur e pyet për famën, ai kthen vetëm një përgjigje, "Unë nuk dua të bëhem shumë i famshëm". Por kjo është e pashmangshme, sidomos së fundmi, kur jeta e tij ka patur dyfish vëmendje, pas lidhjes me Christine Centenera, drejtore e modës në "Vogue Australia". Ata janë shfaqur në rreshtin e parë në një shfaqje të Prada gjatë Javës së Modës në Milano, edhe pse secili në dy vende krejt të ndryshme. Ylli i kinemasë ndezi kureshtjen, teksa u shfaq me një kostum gri të çelët të markës italiane Prada, duke konfirmuar se këtë sezon ai do të jetë fytyra mashkullore e kompanisë së njohur të modës. Konfirmimi u bë akoma më zyrtar, kur çifti e shfaqi romancën e tyre në kopertinën e revistës australiane GQ dhe ai u shpall "Burri i vitit 2023". Ata fillimisht ndezën thashethemet për romancën e tyre pak muaj më parë, kur u fotografuan nga paparacët në një përqafim intim. Joel dhe Christine tashmë janë dy nga personazhet më me ndikim në Australi, duke u shfaqur në skenat ndërkombëtare të modës, si një çift mjaft në modë, kjo edhe përsa i takon pamjes së tyre: ai me një 'look' prej vinkungi, ndërsa ajo provokuese dhe e guximshme përmes stilit. E ndërsa Joel firmosi një kontratë me markën italiane Prada, e dashura Christine, e cila prej kohësh është mikeshë e familjes Kardashian, sapo ka lançuar brand-in e saj të modës, Wardrobe.NYC. Pra, tani kemi një çift krejt të ri dhe të pazakontë në botën e modës, i cili me shumë gjasa do të sjellë shumë risi në botën e modës, por jo vetëm.








EDINBURGH DHE SKOCIA



#NGA EDLINA LOSHA

EDA BANO
DREAMTRAVEL.WORLD






Të shkosh në Edinburgh dhe të kërkosh kohë me diell, nuk je në vendin e duhur!"- pikërisht këtë shprehje kisha lexuar para se të nisesha drejt Edinburgut. Periudha e nisjes më përkoi në tetor, ndaj shprehja më dukej e përshtatshme. Kështu që vendosa me kujdes çadrën te xhepi i jashtëm i çantës së shpinës që ta kisha më të lehtë përdorimin e saj, dhe thashë le të bëhet, ç'të bëhet, por mua shiu nuk do të më ndalojë ta vizitoj këtë qytet, për të cilin kisha dëgjuar aq shumë gjëra të bukura!



Në fakt, vizita e Edinburgh është një eksperiencë e veçantë!
Nga ato qytetet që të mbeten në mendje për bukurinë dhe madhështinë që bartin. Kisha dëgjuar rreth tij, dhe që dallon ndër shumë qytete në Angli apo në botë, por derisa e pashë vetë, nuk më besohej që do të ishte vërtet aq shumë mbresëlënës. Kur udhëton shumë vjen një moment që të duken pothuajse të njëjta të gjitha vendet dhe nuk të krijojnë me sadisfaksion, sado promovime apo reklamime të kenë. Dhe më vjen keq për këtë. Por, në rastin e Edinburgh nuk ndodhi kështu. Një nga gjërat më të bukura të Edinburgh është që të gjithë atraksionet i ka pranë e pranë! Ti mundet të shëtisësh gjithë ditën në rrugën fantastike "Royal Mile", të shohësh ndërtesa të mrekullueshme, pallate me stile viktoriane, të kënaqesh nëpër dyqane suveniresh "We love Scotland", të vizitosh Kalanë, (Edinburgh Castle), ngjitur me të, të provosh një eksperiencë të veçantë në "Camera Obscura and World of Illusions", të shëtitësh gjithë kohën në "Old Town", të impresionohesh nga "The real Mary King's close", të shohësh falas muzeun e shkrimtarëve "The writer's museum", nga ku merr vesh që Robert Burn ka në Edinburgh përmendoren më të lartë që i është ngritur ndonjëherë ndonjë shkrimtari; të shijosh e degustosh whisky në të gjithë lokalet e baret e rrugës, apo ta finalizosh këtë në "Scotch Whisky Experience", duke provuar krenarinë e



Skocisë: whisky-n.
Më pas vetëm dy hapa larg ndodhet lagjja e vogël "Grassmarket", tek e cila mbërrin nëpërmjet "Victoria street", një tjetër rrugë e mrekullueshme dhe e rrallë, me fasada pallatesh ngjyra-ngjyra, e vitrina për t'u admiruar.
Për të ngrenë, Edinburgh nuk të zhgënjen asnjë moment!
Në darkë të gjithë lokalet pothuajse janë me 'music live' dhe më se shumti duhet të prenotosh më parë. Nëse shkon pa prenotuar, gjithsesi skocezet janë shumë të mirë dhe ta kuptojnë "hallin" kur të zë uria: të ulin në banak derisa të lirohet vendi, me birrat fantastike e ullinjtë e mrekullueshëm ia nis që aty! Por nga kuzhina skoceze kurrë nuk mund të zhgënjehesh, përkundrazi!
Edinburgh është i mbushur plot me lokale, bare, restorante- është një parajsë e vërtetë që nga kafexhinjtë e deri te qejflinjtë e whisky-t.
Ka edhe atraksione më të largëta, një nga këta është ai me emrin e çuditshëm "Arthur 's seat", një kodër rreth një milje ngjitje me këmbë, nga ku çuditërisht nuk sheh asnjë "seat"- nuk dihet nga ka ardhur ky emër, por vendi është shumë i bukur pasi ka relievi të thyer kodrinor shumë afër qytetit, gjithë bar e gjelbërim, e bën atë interesant dhe shërben për të parë qytetin nga sipër. Në një tjetër këndvështrim e sheh qytetin nga lart, edhe në "Calton Hill". Një pamje fantastike mbledh shumë vizitorë natë për natë, pasi aty mund të sodisësh edhe perëndimin e diellit!
Sa për shiun? Ahhh, aty po që pata një fat të admirueshëm! Koha fantastike me diell dhe e ngrohtë si pranverë, m'i bëri edhe më të bukura ditët e qëndrimit tim në Edinburgh!
Ky vend të bën ta dashurosh Skocinë!

EDINBURGH CASTLE

Një nga gjërat më të bukura të Edinburgh është që të gjithë atraksionet i ka pranë e pranë! Ti mundet të shëtisësh gjithë ditën në rrugën fantastike "Royal Mile", të shohësh ndërtesa të mrekullueshme, pallate me stile viktoriane, të kënaqesh nëpër dyqane suveniresh "We love Scotland", të vizitosh Kalanë





Maligradi
TË JETOSH NË ISHULL

Eksploroni një ndër vendet më autentike të minoritetit maqedonas në Shqipëri, mes kulturës fetare, historisë dhe një peizazhi mahnitës



Pas hijes së rëndë të Malit të Thatë, duke dredhuar në një rrugë gjarpërushe që duket sikur zgjat pafund, ndalojmë mbi kurrizin e tij gëlqeror për të këqyrë një panoramë spektakolare. Në Perëndim shtrihet fusha e Korçës, e në krahun e Lindjes horizonti në një grykë të përqafur nga malet, që bashkohet nga ujërat e Liqenit të Prespës së Madhe. Sinjalistika rrugore duket sikur të fton të hysh në një zonë, ku nënkuptimi identifikues i emrave nuk është shqip. Ky vend ngjan si një ishull, ndaj vendosëm ta quajmë kështu, sepse ka një kulturë unike, atë të një minoriteti maqedonas, i cili jeton aty prej shekujsh, fill pas faqes së malit, sikur duan të tregojnë se janë ndryshe. E gjithë zona popullohet



nga disa fshatra të minoritetit maqedonas. Fshatrat me shtëpi tipike prej guri dhe fasada të bardha nga Pusteci, që është më i madhi dhe kryeqendra e zonës, deri në atë më skajor Gollomboç, ku gjuha dhe kultura janë tregues etikë, edhe pse më së shumti vendasit komunikojnë në shqip me vizitorët, të cilët vitet e fundit e kanë rritur interesin për të eksploruar këtë zonë. Në të dyja kahet e rrugës mali nuk ka shumë bimësi, kryesisht shkurre e driza, që duket sikur kanë ngulur thonjtë thellë në gurët gëlqerorë.

Prej së largu nisin e shfaqen ujërat e liqenit, e krah tij të vendosur nëpër shpatin e malit janë vendosur fshatrat, njëri pas tjetrit. Prespa e Madhe është i vetmi liqen në Shqipëri, ujërat e të cilit ndahen mes tre shteteve: Shqipërisë, Maqedonisë së Veriut dhe Greqisë, në një sipërfaqe prej 319 kilometrash. I vendosur në një lartësi 853 metra mbi nivelin e detit, ky është liqeni më i lartë në Ballkan. I njohur më së shumti si Prespa e Madhe, ky liqen lidhet me simotrën e tij, Prespën e Vogël. I rrethuar me male të larta mbi 2000 metra lartësi, Prespa konsiderohet një nga zonat më tërheqëse turistike të Ballkanit, me 1500 lloje bimësh, 40 lloje gjitarësh dhe 261 lloje zogjsh, vend ky që konsiderohet edhe si ekosistemi i pelikanit Dalmat. Gjatë verës, ky vend është një destinacion i qetë për pushuesit që duan ujërat e ëmbël, sidomos plazhi Nakoll, një zonë me ujë të pastër dhe të kristaltë, ku zakonisht shkojnë pushues nga zona për rreth, por edhe shumë vizitorë. Peshkimi është një tjetër aktivitet mjaft i përhapur nga banorët vendas, po ashtu edhe vreshtaria.

Nëse keni zgjedhur të kaloni një fundjavë apo 24 orë në Prespë, ju mund të akomodoheni në hotelet dhe bujtinat e vendasve që gjenden kudo, por edhe të shijoni ushqimet me bazë peshkun apo mishin, pjata që kanë një autenticitet në gatim, një ndërthurje e gastronomisë maqedonase me atë shqiptare, e shoqëruar nga vera e kuqe, e cila është një ndër produktet më të dashur të zonës. Gjatë ditës mund të eksploroni zonën e cila ka mundësi të shumta, qoftë pjesën e liqenit, por edhe duke bërë ngjitje në kodrat dhe malet aty pranë.

Një ndër destinacionet më të preferuara që ka edhe një kureshtje të veçantë është ishulli i Maligradit. Me formën e një trapezoidi dhe sipërfaqe prej 5 hektarësh, nga maja e tij mund të shihni një panoramë të mrekullueshme, që sheh 360 gradë Shqipërinë, Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut. I njohur ndryshe si ishulli i gjarpërinjve, pasi mendohet se aty ka shumë të tillë, aty mund të shkohet brenda pak minutash me varkë, e cila merret nga fshati Pustec, ku gjendet edhe një mol i vogël. Emri Maligrad në shqip do të thotë Qyteti i Vogël. Edhe pse në një sipërfaqe të vogël, aty ka shumë për të eksploruar. Në ishull gjendet Kisha e Shën Mërisë, e cila daton në shekullin XIV. Konsiderohet një monument fetar, i cili spikat për ikonografinë dhe afresket shumëngjyrëshe të shenjtorëve. Në pjesën e sipërme të ishullit, e cila është e arritshme nga ana verior-perëndimore, janë gjetur rrënojat e vilës verore të Car Samoilit që i përkiste shekullit të X-të, ku edhe janë gjetur varre masive, të cilat dëshmojnë historinë dhe kulturën e zonës së Prespës.

Nëse vijoni udhëtimin përqark ishullit, pasi jo të gjitha zonat janë të arritshme me këmbë, në pjesën lindore ndodhet kisha eremite e Shën Mëhillit. Nga vetë fjala eremite, ajo është një shpellë e cila ka dy hyrje: një në pjesën e poshtme ku qëndronin murgjit dhe tjetra në pjesën e sipërme, e cila ka piktura murale e afreske. Pasi të keni vizituar ishullin, mund të eksploroni zonën duke shkuar në Pustec, një shëtitje përgjatë bregut deri në kufi, e të ktheheni pas. Gjatë kthimit mund të vizitoni Cerna Korpa (Guri i Zi), ku gjendet një tjetër kishe eremite në shpellë, e cila quhet Bllashtojna. Me anë të një shkalle prej hekuri e ndërtuar vitet e fundit, mund të ngjiteni në 25 metra lartësi dhe në brendësi mund të shijoni qetësinë e kishës dhe ikonostaset plot ngjyra, të cilat datojnë që nga shekulli i XIV. Nëse ecni përgjatë krahut perëndimor të liqenit, pranë kufirit me Maqedoninë e Veriut, ndodhet kisha eremite e Shën Mërisë, një monument kulture e shekullit të XIII, e vendosur në mes të një peizazhi mahnitës, e njohur për stilin ikonografik bizantin të afreskeve.

Me formën e një trapezoidi dhe sipërfaqe prej 5 hektarësh, nga maja e tij mund të shihni një panoramë të mrekullueshme, që sheh 360 gradë Shqipërinë, Greqinë dhe Maqedoninë e Veriut.







KU TË QËNDRONI

Përpos vizitës në Parkun Kombëtar të Liqeneve të Plitvicës, një udhëtim ditor në qytete si: Zadari, Shibeniku ose Spliti, janë vendi i duhur, ku mund të eksploroni traditën dhe kulturën tipike kroate. Ka disa hotele që gjendet brenda parkut, ku mund të qëndroni për një natë para se të eksploroni zonën ose mund të hyni në brendësi në zonën Rastovača dhe Jezercë, ku mund të akomodoheni me çmime më të lira.

LIQENET E PLITVICËS

Udhëtoni në vendin përrallor të Kroacisë, mes ujëvarave e liqeneve magjike të mbrojtura nga UNESCO



ÇFARË TË HANI

Për sa i përket ushqimeve, shumica përmbajnë mish, por një ndër më tipiket janë gjellët "dželadija", të përgatitura me mish derri, viçi ose deleje, të shoqëruara me lakrën tipike "kalje". Po ashtu, një nga pjatat kryesore më të famshme është qengji i pjekur në skarë, i shoqëruar me produkte vendase, si djathi dhe perimet e pjekura.

Në rajonin malor të Kroacisë, mbuluar plot me pyje të harlisur, livadhe mahnitëse dhe shkëmbinj gëlqerorë, gjendet parku kombëtar më i vjetër dhe më i madh i liqeneve të Plitvicës. Ky park i jashtëzakonshëm ka një bukuri natyrore, me 16 liqene, ujëvara dhe një gjelbërim të mrekullueshëm, gjithçka e mbrojtur nga UNESCO. Mund të zgjidhni të ecni nëpër shtigje apo të vozisni në kajak në ujërat e kristalta. Liqenet e Plitvicës janë një nga vendet më të bukura natyrore, që kemi parë ndonjëherë në Evropë! Plot 16 liqene të ndërlidhura mes tyre mes disa ujëvarave, ku gjendet një habitat natyror me specie të panumërta bimore dhe shtazore.

Para se të filloni udhëtimin, fillimisht vendosuni në fshatin Rastoke, i cili gjendet pranë një ujëvare me të njëjtin emër dhe pas një dite pushimi, mund të përgatiteni për udhëtimin tuaj.


Nuk ka dyshim që liqenet janë pjesa më tërheqëse e parkut, ndaj niseni udhëtimin tuaj duke ecur nëpër shtigjet e bukura të krijuara me rrugëkalime prej druri, prej nga mund të shijoni një peizazh përrallor. Niseni turin tuaj nga liqenet e Poshtme. Ato gjenden brenda një gryke gëlqerore, 40 metra të thellë. Ndryshe nga pjesa tjetër e liqeneve, këto katër liqene të vegjël janë relativisht të cekët. Nëse hyni nga hyrja e parë, do të takoheni me disa ujëra mahnitëse. Më pas vazhdoni të ecni nëpër shtegun e famshëm prej druri, prej nga do të shijoni pamjet mahnitëse. Pikërisht në momentin kulmor të ditës, rrezet e diellit e bëjnë ujin të kaltër, duke dhuruar një peizazh ku gërshetohet kaltërsia e ngjyrës blu të ujit që lëviz tatëpjetë në ujdhesat e vogla, duke krijuar liqene të vogla. Një prej vendeve më të bukura dhe po aq të preferuara nga turistët është ujëvara Veliki Slap, e cila gjendet pranë liqeneve të ulëta, ajo gjendet në një lartësi prej 78 metrash dhe ndryshe nga ujëvarat e tjera, ajo duket kaq madhështore sepse ushqehet nga lumi Potok.

Më pas mund të vazhdoni rrugën drejt liqeneve të Epërm, ku do të takoheni me disa liqene, plot 12 të cilat mbizotërohen nga një ngjyrë e bukur jeshile e thellë. Ato janë aq të mëdha, sa mund të ecni rreth tyre për orë të tëra. Një nga pamjet më spektakolare është uji që rrjedh nga liqeni më i lartë, ai Proscanskos, deri në fund që është liqeni i Kozjakut, i cili është i fundit i Sipërm. Gjithçka mund të arrihet, nëse e bëni rrugën tuaj duke ndjekur disa shtigje të ndërtuara me ura prej druri, që qarkojnë përreth pyllit duke ecur në skajet e liqeneve. Në fund, gjendet liqeni i Kozjakut, i cili është më i madhi dhe më i thelli në Plitvicë. I njohur si i fundit i Liqeneve të Sipërm, ai mbulon një gjatësi totale prej 2,35 kilometrash dhe është rreth 48 metra i thellë. Nëse doni që të shëtisni dhe të keni një panoramë më të plotë, mund të merrni një traget të vogël, prej nga mund të shijoni gjithë natyrën.

Ndërkaq, për ata që janë të apasionuar pas sporteve plot adrenalinë, mund të ecin mbi kajak në lumin Mreznica. Lumi gjendet në veri të liqeneve të Plitvicës, një zonë e paprekur dhe larg zhurmës. Pika e fillimit për të nisur turneu me kajak, shtrihet 40 minuta nga hyrja e liqeneve të Plitvicës dhe është e lehtë për t'u arritur me makinë. Ju mund të rezervoni paraprakisht një turne me kajak, si dhe mos harroni të merrni me vete kostumin e duhur. Periudha ideale për t'u vizituar është pranvera dhe vjeshta. Në vjeshtë, ngjyrat ndryshojnë si me magji, duke reflektuar nuancat e ndryshkut ngado.




1



2



3



4




5

DRU & Metal

Nëse përdorni objektet e duhura, edhe ato që kanë pesha të rënda, mund të krijoni një stil unik, por edhe meditues të mjedisit ku jetoni. Format e çuditshme, me materiale metalike, efekt bronzi apo ari, shpesh konsiderohen si tejet të vështira për t'u gjetur vendin, por nëse përdorni intuitën, ato mund të rrinë shumë mirë kudo. Shumica e tyre kanë pamje paksa antike, me nuancë vintage, duke kombinuar motivet e drunjta me ato metalike, ju mund të krijoni një tjetër dimension të dhomës suaj të ndenjes, ndaj guxoni të provoni, duke i alternuar ato me objekte moderne.





6



7



8



9

1. Vazo qeramike nga Hitoshikato **2.** Mbajtëse librash nga studio Henry Wilson
3. Stol nga Pirre Chapo **4.** Ndriçues nga Sergio Rodrigues
5. Zinxhirë dekorues nga Michele Quan **6.** Mbajtëse letrash nga Colin King x Audo
7. Vazo dekorative nga Colin King x Audo **8.** Kuti magazinimi nga Colin King














Ethet e ARIT

Në kohët moderne, kur ngado mbizotëron minimalizmi në stilin e shtëpive tona, mobiliet dhe aksesorët me efekt metalik, po bëhen gjithnjë e më pëlqyera. Ngjyra e artë sidomos, me nuancë tejet shkëlqyese, është një dozë e shtuar në çdo shtëpi dhe duket se po lulëzon dita-ditës. Nëse e doni këtë pamje, atëherë duhet të guxoni, sepse nëse efekti i florinjtë, vërtet reflekton qartazi dhe luksin, por lëviz në atë kufirin e hollë, ku gjithçka mund të shkatërrohet, edhe nga një objekt i vetëm. Ndaj, pikë së pari, zgjidhni aksesorët e duhur me efekt të pranuar, e më pas gjeni vendin e duhur.











Chef GËZIM MUSLIAKA
MARCHESI GOURMET

Një udhëtim në botën gastronomike të chef-it të njohur të kuzhinës, një përjetim shijesh dhe eksperiencash unike, që vjen nga lashtësia deri në ditët e sotme



Një vilë e bukur e vendosur mbi kodrat përqark Tiranës, prej vitesh e kthyer në një restorant nga chef Gëzim Musliaka. Marchesi Gourmet nuk është as vetëm një vilë, as vetëm një restorant i zakonshëm, pasi mban kudo frymën e chef Gëzimit, nga produktet që prodhohen në bahçen aty pranë dhe janë qeliza që frymëzon konceptin e pjatave të rralla, që serviren në një mënyrë unike. "Bordo" udhëtoi një fundjavë në këtë vend të njohur jo vetëm për gatimet dhe cilësinë, por edhe për një destinacion çlodhës, për familjen tuaj dhe jo vetëm.

Chef Gëzimi, me çfarë mund të nisim drekën në Marchesi Gourmet?

E fillojmë më një pjatë starter. Zakonisht pastat mund të vendosen edhe në fillim. Është pjesë me përmbajtje të plotë karbohidrate, por që mund të vendosen edhe në mes të menusë. Menunë sot e fillojmë me një pastë, e cila ka si bazë salcën tonë. Kështu vazhdon e përgatit stomakun për pjatat e tjera që do të vijnë. E veçanta e kësaj paste është se salca në përmbajtjen e vet, ka edhe disa kombinime të thjeshta, pra nuk është 100% domate. Në qoftë se i referohemi një recete standarde, atë mund ta shikojmë nga vjen dhe tradita jonë që në këtë rast është shumë e pasur.

Po më pas me çfarë shoqërohet?

Në pjatat e tjera do të kemi në përmbajtje proteinën. Një zog fshati të gatuar në furrë druri. Do të marrim vetëm pjesën e involtinit dhe pastaj do ta shoqërojmë me një krem bizele. Ka brenda edhe pjesën e qullit që ne i themi polenta. Ngjan në dukje e vogël, por është pjatë e plotë.

Ngjan si një vepër arti! Vetëm nga pamja e saj të zgjon të gjitha shqisat…

Sepse gjithçka nis nga ndikimi i të shikuarit, pastaj vjen i të



nuhaturit dhe në fund të shijuarit. Kjo është forma bazë e përgatitjes shpirtërore, para se të hyjmë tek analiza sensoriale. Kjo është një involtini i zogut të fshatit me qullin, por ka dhe elementë krokantë, të cilët në analizën sensoriale janë elementët e territorit. Territori ka dhe elementë të butë dhe elementë të lëngshëm, ka dhe elementë të fortë krokantë, të cilët japin pasqyrimet e territorit. Është një minipasqyrim i natyrës. Pastaj kur futemi në analizën e të shijuarit, do të shikosh edhe pjesën e tymosur të mishit, edhe pjesën e filetos së bardhë të bashkuar me muskulin e kuq. Pjesa e qullit është gatuar me lëngun e mishit, që ka një shije komplekse. Lëngu i bizeles është ai që themi neutralizuesi, bashkuesi, pra është ajo harmonia e fshehtë që ndodh, sepse senset pranojnë edhe pjesën e kontrasteve që krijojnë harmoni. Kjo pjatë i ka të gjitha.

Me çfarë e keni shoqëruar tjetër?

Ka edhe bajame të pjekura në furrë, të cilën e kemi kaluar në tigan duke e karamelizuar le të themi, por nuk ka elementë sheqeri. Thjesht e karamelizuar në vetvete.

Te kjo pjatë fortësia është shumë e mirë, as e fortë, as e qullët….

Kjo gatuhet në 'breze' quhet. Skuqet mirë në yndyrën e vet, lihet në avull dhe pastaj gatuhet me verë. Është komplet gjë e veçantë kjo.

Po pjata e tretë çfarë ka, duket fantastike, aq e bukur sa mua më vjen keq tani ta prish?

Kjo është pjatë kryesore, pjatë me mish viçi, i gatuar gjatë në temperaturë të ulët, 4 deri në 5 orë me 72°gradë. Fillimisht skuqet me yndyrën e vet, me dhjamin e gjëndrave mbiveshkore. Ai është dhjami më i mirë brenda species dhe ka temperaturën më të lartë të gatimit. Pjata shoqërohet me patate "pave', një lloj patate e shtresëzuar që do kohë të gjatë në përgatitje. Ka edhe një krem të veçantë patëllxhani, panxhar dhe pak speca që pjata të ketë kompleksitetin e shijeve dhe harmoninë e brendshme, pavarësisht se konsistenca vjen duke u plotësuar, duke u bërë më e plotë. Edhe pijet që shoqërohen do të sugjeroja verë të kuqe, të ishte e plotë dhe e mbajtur gjatë. Deri tani kemi shkuar duke u ngritur, një ngritje normale që e përballon mirë organizmi.

Si ndiheni kur klientët ju pyesin për pjatat, a i vlerësoni ata që janë kuriozë?

Patjetër, sepse besoj se ata që janë kureshtarë, kërkojnë diçka, një vibrim në përgjithësi, vibrim kulturor dhe kulturash. Shiko çfarë ndodh, nuk mundet kurrë që kulturat të jenë të veçuara. Nga difuzioni i njerëzve, transmetohen dhe kulturat. Ajo që është më e thjeshta për t'u transmetuar është kultura gastronomike, e cila rri bashkë me pjesën etnografike të kostumeve, dekorin dhe me stilin e jetesës. Por ka lidhje edhe me aktivitetin fizik dhe atë mendor, sepse 20 për qind të energjive e harxhon vetëm truri dhe këtë e sigurojmë nëpërmjet ushqimit.

A kemi ne një traditë të lashtë gastronomike?

Zona rurale konservon shumë nga pjesë nga tradita jonë e lashtë, sepse ne jemi një popull bashkëkohës me helenët dhe romakët. Kultura jonë është akoma duke u zbuluar, kemi informacion mjaftueshëm për të treguar që kemi dhënë në qytetërimet e kohës, siç kemi dhënë xhubletën, fustanellën, opingën apo këmishën ilire e cila u kaloi më vonë romakëve. Shumë nga elementët tanë i kam në librin tim: recetat që romakët i morën nga Epiri dhe Iliria, duke i importuar dhe pastaj i bënë të tyren. Kjo lloj përshtatje është në kulturën e të gjithë popujve. Ne kemi qenë të preferuar, aq sa vreshtat romake u shpërngulën në shekullin e parë dhe të dytë, kur Roma ishte në shkëlqimin e vet, sepse ilirët e njihnin kulturën e vreshtarisë, kishin vreshta dhe varitete autoktone, siç i kemi dhe sot. Shumë nga ato që kanë lëvizur në pjesën e perandorisë romake e kanë patur origjinën këtu te ne.



Dhe në fund, po e mbyllim me një ëmbëlsirë?

Kjo është një zupë angleze siç themi ne, ose zupa sipas mënyrës sonë. Jemi munduar që ëmbëlsirën që ka qenë shumë e mirë në brezin tonë, ta ruajmë. Është një përmbyllje e asaj që ke provuar, ka një lidhje shijësore: sheqeri dhe kremi është në masën e duhur, çokollata dhe kakao po ashtu. Është një përmbyllje e një vakti, një dreke që të lë kohë që të vazhdosh aktivitetin prapë.

3 PJATA ME MISH PËR ÇDO SHIJE



Në vjeshtë të gjithë janë para dilemës, çfarë produktesh duhet të zgjedhin për të përgatitur pjatat e tyre? Kërpudha, kungulli i verdhë e sidomos frutat, janë ideale për këtë sezon, po ne kemi vendosur që t'ju sugjerojmë 3 pjata me bazë mishin, të cilat mund të realizohen lehtësisht në shtëpi, duke i kombinuar me fruta dhe perime vjeshtore.

FAGOTTINI ME LAKËR DHE DJATHË

Përbërësit:
500 g mish viçi të prerë në feta të holla, 1 lakër e kuqe 250 g, 40 g kokrra arre, 40 g djathë parmixhano, 50 g thërrime buke, 100 ml qumësht, 50 g miell, 1 thelbi hudhër, 1 ml verë e bardhë, 100 g djathë taleggio, vaj ulliri ekstra i virgjër, 30 g gjalpë, piper i zi dhe kripë

Përgatitja:
Pastroni lakrën, shpëlajeni dhe thajeni. Hiqni disa gjethe mënjanë për dekorim dhe pjesën tjetër priteni në copa të vogla. Shkrini gjalpin në tigan, shtoni 1 lugë vaj ulliri dhe më pas lakrën. Shtojini kripën dhe lëreni të ziejë në zjarr të fortë për 5 minuta.
Hiqni lakrën nga zjarri, kullojeni nga lëngu dhe hiqeni mënjanë. Pasi lakra të ftohet, përziejini me kokrrat e arrave të grira, djathin parmixhano, thërrimet e bukës të njomura në qumësht e të shtrydhura dhe piper të sapobluar. Përzierjen punojeni me dorë dhe kur të marrë formë, krijoni topa me madhësinë e dëshiruar, si forma e qofteve.
Ndërkohë fetat e mishit, rrihni me një çekiç kuzhine. Vendosini më pas në letër për pjekje dhe brenda futni një top qofteje. Paloseni mishin përqark me letër, lidheni me fije kuzhine dhe vendoseni në një tavë të lyer me miell. Vendosni të gjitha fetat e mishit me qofte, shtojini hudhër dhe pak kripë dhe vendosini për pjekje. Kthejini ato nga secila anë dhe shuajini me verën, derisa ajo të avullojë. Në fund mbulojeni dhe lëreni të ziejë në zjarr të ulët, për 15 minuta. Hiqeni nga zjarri, pastrojini nga fijet dhe shtojini sipër djathin. Shërbejeni me salcë, piper të zi dhe gjethe lakre



NUGGET GJELDETI ME BAJAME DHE KOKOS

Përbërësit:
400 g mish i grirë gjeldeti, 120 g pluhur bajame, 100 g pluhur kokosi, 2 vezë, spec djegës pluhur, 1 avokado, 100 g salcë kosi, 1/2 limon, 1 fletë marule, vaj kikiriku dhe kripë

Përgatitja:
Në një tas përzieni mishin e grirë të gjelit të detit me pak kripë, një majë spec djegës, 80 gramë pluhur bajame dhe vezët e rrahura veçmas. Përziejini përbërësit, derisa të përftoni një brum homogjen.
Merrni brumin dhe me të formoni një qofte ovale, të cilat i shtypeni pak. Përsëriteni hapin derisa përzierja e mishit të përfundojë. Hidhni në një pjatë pluhurin e mbetur të bajameve dhe atë të kokosit, dhe përziejini. Merrni qoftet dhe lyejini në të dyja krahët me pluhurin, duke i mbuluar plotësisht.
Ndërkohë ngrohni vajin e kikirikut në tigan në temperaturë 160°. Hidhni qoftet për t'u skuqur, për 5 minuta nga çdo anë. Ngrijeni zjarrin dhe lërini për 2 minuta të tjera, derisa të marrin ngjyrë të artë. Hiqini nga tigani dhe kullojini në letër për skuqje, duke i rregulluar me pak kripë. Shërbejini të ngrohta me gjethet e sallatës së prera në feta të trasha, shoqëruar me avokado dhe lëng limoni.



Përgatitja:
Fillimisht qëroni dhe grijeni imët qepën. Bashkojeni qepën në një tenxhere me 2/3 e manaferrave, thelpinjtë e hudhrës, sheqerin kaf, xhenxhefilin dhe piper të zi. Përziejini dhe lëreni të ziejnë në zjarr të ulët për 20 minuta. Më pas me një blender përzieni, derisa të krijohet një masë kremoze. Thërrmimet e bukës lagini me qumësht dhe lërini të zbuten. Kullojini dhe shtrydhini, pastaj përziejeni në një enë me mishin e grirë, qepët e njoma të grira hollë së bashku me gjethet e rozmarinës, vezën, salcën Uorçester, pak kripë dhe pak piper. Masën e krijuar transferoheni në një fletë furre dhe formoni një formë roleje kompakte. Lyeni sipërfaqen me një pjesë të salcës së manaferrave dhe e vendosim në një tepsi, e më pas për pjekje në furrë të nxehur paraprakisht në 180 gradë Celsius për 1 orë e 15 minuta, duke e spërkatur herë pas here me salcë.
Hiqeni nga furra, lëreni të pushojë për 10 minuta dhe shërbejeni me salcën e mbetur. Lyejini edhe me pak gjalpë sipër, pak kripë dhe 3 lugë ujë. Dekoroni sipas dëshirës me gjethe rozmarine.

MISH I PJEKUR ME MANAFERRA

Përbërësit:
650 g mish viçi i grirë, 2 qepë të njoma, 1 degë rozmarinë, 1 lugë gjelle salcë Uorçester, 1 vezë, 60 g thërrime buke, 200 ml qumësht, 1 qepë e bardhë, 1 thelbi hudhër, 300 g manaferra, 80 g sheqer kaf, 1 lugë xhenxhefil pluhur, piper i zi, kripë, 20 g gjalpë







T I R A N A

NË TYM ME Red Bull CAR PARK DRIFT

Kompeticioni plot emocione dhe adrenalinë "Red Bull Car Park Drift" erdhi për herë të parë në Shqipëri, si pjesë e kualifikueseve botërore në datat 6 dhe 7 tetor, në sheshin "Nënë Tereza", në Tiranë. 22 drifterët më të mirë nga e gjithë Shqipëria dhe Kosova garuan për të shpallur vetëm një prej tyre, si mbretin e driftit shqiptar. Duke dëgjuar zhurmën në sfond të driftit, që bënin makinat e modifikuara, kompeticioni "Red Bull Car Park Drift", si një ngjarje e paharrueshme e autosportit, pa pilotët të manovrojnë me pengesat, duke nxjerrë sa më shumë tym që të ishte e mundur, për t'i bërë përshtypje 4 gjyqtarëve të jurisë dhe mijëra spektatorëve në kryeqytet, të cilët ndoqën me emocione këtë garë. Juria e përbërë nga drejtori i projektit Yusif Bassil, piloti i Red Bull-it Abdo Feghali, tekniku Jean Pierre Nesrallah, piloti Alex Grincuk dhe kampioni shqiptar në supermoto: Erjus Tufa shpallën fitues drifterin Lirim Gjura, i cili do të përfaqësojë Shqipërinë në finalen botërore të "Red Bull Car Park Drift" në Doha, Qatar në dhjetor të vitit 2023. Kampionati "Red Bull Car Park Drift" u lançua për herë të parë në Liban në vitin 2008, nëpërmjet të cilit ju dha mundësia të gjithë të apasionuarve pas driftit, për të vënë në provë aftësitë e tyre brenda një mjedisi sportiv, i cili respekton të gjitha standardet e sigurisë.

































VIP-at NË **TAPETIN E KUQ** TË "NË KUADËR TË DASHURISË"








Filmi "Në kuadër të dashurisë" pati premierën mbrëmjen e 9 tetorit. Një ceremoni e kuruar në detaje mblodhi kastin e aktorëve, të ftuarit VIP si dhe dashamirës të filmit në premierën që u komentua gjatë në media e më gjerë. Ceremonia nisi me parakalimin e yjeve në tapetin e kuq, projektuar dhe vendosur në të gjithë pjesën e përparme të Pallatit të Kongreseve, nga ku u shfaqën me gjithë shkëlqimin e tyre disa prej emrave të mirënjohur të skenës, filmit apo televizionit. Mënyra e konceptit të preludit të asaj mbrëmjeje, para se të gjithë të pranishmit të futeshin brenda ambienteve të Pallatit të Kongreseve për të ndjekur filmin, nuk kishte asgjë më pak se ceremonitë dhe eventet madhështore të Hollywood-it apo më gjerë. Nga Olta Gixhari e Luiz Ejlli, të cilët janë protagonistë të filmit, e deri te çifti i producentëve Sara Hoxha e Ledion Liço, çdo personazh që parakaloi në shtrojën e kuqe të yjeve, vodhën vëmendjen e çdokujt që ishte i pranishëm, apo që i ndoqi nëpërmjet rrjeteve sociale. "Në kuadër të dashurisë" është një prodhim i Top Channel e kryesisht vjen nën kujdesin personal të Ledion Liços, si producent i këtij prodhimi kinematografik, ndaj duke e njohur pasionin dhe lidhjen e ngushtë që Liço ka me ngjarje të rëndësishme të filmit, në eventin e 9 tetorit u duk ndjeshëm 'prekja' e tij. "Bordo" ishte e pranishme në premierë dhe ju ofron foto ekskluzive të emrave të njohur VIP, që parakaluan në tapetin e kuq.
















BORDO horoskopi nëntor 2023



Çfarë thonë yjet për këtë nëntor

DASHI

Këtë muaj duhet të dëgjoni instinktin tuaj, sepse një mundësi pune mund të vijë nga lidhja me dikë nga e kaluara. Synimi juaj është një eksperiencë e re, ndaj provoni pa kompromise zgjidhjet që do t'ju ofrojnë, duke lënë mënjanë egon tuaj. Ka ardhur momenti të jeni të lumtur me pak, sepse bollëku do të vijë në të ardhmen.

VIRGJËRESHA

Do të kaloni momente luhatjesh të forta emocionale dhe shëndetësore, si dhe priten disa ndryshime në punë. Ka shumë gjasa që impulsiviteti dhe ndjeshmëria juaj mund të nxitë këtë muaj disa trazira në aspektin profesional. Shmangni përplasjet me kolegët, sepse do të lëndoheni shumë dhe rrezikoni vendin e punës.

DEMI

Gjatë sezonit të eklipsit, duhet të jeni të vëmendshëm ndaj bisedave që kanë të bëjnë me ju, në drejtim të eprorëve tuaj. Mos e kaloni asnjëherë cakun. Nga ana emocionale, do të përjetoni një periudhë të muajit në të cilën do ta keni më të lehtë të shfaqni pasionet tuaja, ndaj mos nguroni të tregoni aspektin tuaj krijues.

PESHORJA

Për të treguar se çfarë keni arritur në karrierën tuaj, nuk duhet doemos t'i reklamoni ato. Euforia e tepruar nuk bën aspak për ju, ndaj tregojeni gjithçka me përulësi. Relaksohuni dhe përqendroheni te vetja, dhe nevojat tuaja emocionale. Programoni disa ditë pushimi larg zhurmës, kjo është ajo që ju duhet për t'u rikuperuar.

BINJAKËT

Gjithë sezonin e dimrit, duhet të jeni në gjendje të rimendoni idetë dhe filozofitë tuaja, që ndoshta deri tani ju kanë udhëhequr: nëse vazhdoni të këmbëngulni me to mund të përballeni me disfata. Jeni një shenjë plot talente, ndaj nëse ky është momenti, mos nguroni të shfaqni atë me gjithë potencialin dhe format e saj.

SHIGJETARI

Gjatë nëntorit do të gjendeni para zgjedhjeve të vështira, kështu që mbani gjithmonë një plan rezervë, sepse jo të gjitha parashikimet do të dalin ashtu si duhet. Në ditët e para të muajit të nëntor do të kaloni një situatë kritike me shefin, i cili do të reflektojë autoritetin për ju, ndaj përpiquni që të shfaqni disponimin tuaj.

GAFORRJA

Ky muaj do t'ju sjellë lajme pozitive që ju nevojiten për të shëruar plagët, që nuk i keni shëruar plotësisht. Fjalët lëndojnë lehtësisht, veçanërisht nëse vijnë nga dikush që e doni shumë. Përfitoni më të mirën nga ky moment kalimtar dhe reflektoni për gjithçka që dëgjoni, duke e përdorur për projektet e ardhshme.

BRICJAPI

Për të gjithë të lindurit në pjesën e dytë të muajit do të shfaqet një situatë kritike në aspektin financiar, ndaj bëni kujdes për të ulur shpenzimet dhe buxhetin që keni planifikuar për blerjet. Ky është një muaj kur mund të ndiheni jashtëzakonisht të lumtur dhe tolerantë, ndaj përpiquni të konsideroni rikthimin te miqësitë e vjetra.

LUANI

Jeta juaj e dashurisë do të përfshihet nga disa ndryshime apo ribashkime, që nuk i kishit parashikuar. Ky është momenti i duhur që në çdo bisedë apo negociatë, të kërkoni të vendosni kufijtë dhe të mbroni atë që e konsideroni tuajën. Përfitoni nga kalimi i hënës në shenjën tuaj, për të sqaruar gjërat që kishit lënë pezull.

UJORI

Ky muaj do të jetë shumë interesant dhe fokusi do të jetë në sektorin profesional. Nëse keni në plan të merrni vendime të rëndësishme, jini të kujdesshëm dhe kërkoni mendimin e partnerit. Ndërkohë që do t'i gëzoheni sukseseve nga puna, është mirë që të kujdeseni edhe për shëndetin. Kujdes nga problemet kronike.

AKREPI

Familja juaj dhe vendimet që do të merrni për të ndërtuar një projekt së afërmi, janë temat që kërkojnë vëmendjen. Ju jeni duke jetuar një periudhë, në të cilën prisni disa ndryshime radikale. Besojini një miku, i cili do të shfaqet papritur në jetën tuaj dhe me gjasë do të jetë një bashkëpunëtor në kauzat që keni filluar.

PESHQIT

Këtë muaj është momenti të njihni më mirë veten dhe jetën tuaj, duke bërë pyetje dhe duke kërkuar përgjigje. Qëllimi juaj është të kapërceni të gjitha kufijtë përmes arsyes. Nëse keni nisur një projekt, mos e lini përgjysmë. Disa marrëdhënie të nisura këtë verë, do t'ju shqetësojnë emocionalisht, ndaj ruani qetësinë.



ALBANIA

AUTORI:

MAURIZIO BOSIO

ÇMIMI: 4250 LEKË

Autori dëshiron të transmetojë mesazhin: kujdesuni për bukurinë e vendit tuaj, ruajeni për brezat e rinj, parandaloni ndërtimin pa kriter, neglizhencën ndaj veprave të artit apo vjedhjen e tyre. Ata që vizitojnë Shqipërinë, nuk duhet të krijojnë një vizion sipërfaqësor të vendit, por të përpiqen të depërtojë në thellësitë e shpirtit të tij magjepsës. Nëntitulli "Bardhë e zi" tregon qëllimin simbolik të imazheve unike, për t'i nxitur lexuesit të ruajnë bukurinë e vendit, përpara se të humbasë në mënyrë të pakthyeshme.



BARNATORJA E HUMBUR

AUTORI:

SARAH PENNER

ÇMIMI: 1250 LEKË

Fshehur në thellësitë e Londrës së shekullit 18, një barnatore sekrete ka kliente të pazakontë. Gratë flasin për një njeri misterioz me emrin Nela, e cila shet helme të maskuara mirë. Fati i barnatores vihet në rrezik, kur një kliente 12-vjeçare bën një gabim të rëndë. Ndërkohë, në Londrën moderne, Karolinë po e kalon vetëm 10-vjetorin e martesës, në një situatë të vështirë. Kur i bie rastësisht në dorë diçka për vrasjet e pazgjidhura, që tronditën Londrën 200 vjet më parë, ajo ndesh jetën e barnatores dhe dikujt nuk do t'i shkojnë punët mirë.




NJË MIQËSI

AUTORI:

SILVIA AVALLONE

ÇMIMI: 1250 LEKË

Përpara se ta njihnin të gjithë, në mbarë planetin, Beatriçja ishte një vajzë e zakonshme. Ishte nata kur Beatriçja u shfaq në plazh - me sy të gjelbër smerald që shkëlqenin në errësirë. Të gjithë mendojnë se e njohin atë, Beatriçen: e dinë se çfarë vesh, çfarë ha, ku shkon me pushime. E admirojnë, e kanë zili, e urrejnë, e adhurojnë. Por askush, nuk e merr me mend sekretin që fshihet pas buzëqeshjes së saj përherë të njëjtë, askush nuk e imagjinon kohën kur "Roseti" ishte vetëm Bea - shoqja e saj më e mirë.



ROTSHILDËT

AUTORI:

EGON CAESAR CONTE CORTI

ÇMIMI: 2000 LEKË

Për familjen Rotshild rreken mite dhe legjenda të panumërta. Nga "Rrugica e Hebrenjve" në Frankfurt, ato u bënë fuqia e parë financiare e Europës. Majer Amshel Rotshild, themeluesi i dinastisë ngriti një biznes për kambizëm, duke realizuar të gjitha transaksione financiare në të gjithë Europën. Bashkë me të ardhurat u rrit edhe familja, e cila themeloi bankën "Mayer Amschel& Söhne". Pas vdekjes, 5 djemtë e tij do ta zgjeronin aktivitetin në Evropë e më gjerë, duke e kthyer në bankën private më të rëndësishme në botë.



VETËM PËR DASHURINË

AUTORI:

CHRISTINA LAUREN

ÇMIMI: 1200 LEKË

Mejsi punon si pediatre dhe po planifikon martesën me një burrë në moshë, por të sigurt financiarisht dhe ka vendosur ta bëjë zemrën gur. Por, rastësisht takon Eliotin, dashurinë e parë. I rrëfyer në intervale kohore nga adoleshenca deri në ribashkimin e rastësishëm, kujtimet errësohen nga agonia e asaj që ndodhi një natë shumë vite më parë. Tani Eliot do të arrijë të kuptojë të vërtetën pas heshtjes dhjetëvjeçare të Mejsit dhe do të duhet të kapërcejë të kaluarën dhe veten, për të ringjallur besimin e saj në mundësinë e një dashurie gjithëpërfshirëse.



NDALESA E FUNDIT E AUSCHWITZ

AUTORI:

EDDY DE WIND

ÇMIMI: 1200 LEKË

Nga fundi i vitit 1944, gjermanët braktisin Aushvicin dhe marrin me vete të burgosurit e mbetur, duke i detyruar të shkojnë në kampet e Gjermanisë. Ndërsa Eddy De Wind fshihet në një barakë, Friedeli, e shoqja, s'merr guximin të bëjë si ai. Eddy gjen një bllok dhe nis të shkruajë historinë e tij. Ai dhe Friedeli u njohën në kampin e Westerborkut; ai ishte mjek dhe ajo infermiere. Ata ishin dashuruar dhe martuar brenda kampit, por ajo parantezë e brishtë s'ishte e thënë të zgjaste. Hipur në karvanët e vdekjes, ata ishin shpërngulur në Aushvic.


+355 693 333 999
multibrand.al
www.multibrand.al
KARL
KARL LAGERFELD
ZBULONI KOLEKSIONIN
RRUGA BRIGADA VIII, TIRANA